



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.9

9 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 060 datë 26.1.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.....	209
Ligj nr.10 061 datë 29.1.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për zbatimin e projektit të asistencës teknike, në mbështetje të modernizimit të sistemit të regjistrimit civil në Shqipëri”.....	218
Ligj nr.10 062 datë 29.1.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”.....	221
Ligj nr.10 063 datë 29.1.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind” të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”.....	241
Ligj nr.10 064 datë 29.1.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës së Greqisë”.....	245
Ligj nr.10 065 datë 29.1.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.....	247
Vendim i KM nr.82, datë 27.1.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”.....	248
Vendim i KM nr.98, datë 27.1.2009	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara	250

LIGJ
Nr.10 060, datë 26.1.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8432, DATË 14.12.1998 “PËR
AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Zyra për Refugjatët” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët”.

Neni 2

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “a mbrojtje të përkohshme” zëvendësohen me fjalët “ose mbrojtje plotësuese”.
2. Në pikën 2, fjala “të përkohshme” zëvendësohet me fjalën “plotësuese”.

Neni 3

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Konventa e Gjenevës” është konventa për statusin e refugjatëve, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967.
2. “Azil” është mbrojtja që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve ose personave në mbrojtje plotësuese.
3. “Kërkesa për azil” është çdo deklaram i bërë me shkrim, me gojë apo me gjeste, nga një shtetas i huaj ose një person pa shtetësi, para organeve kompetente, në kufi apo brenda vendit, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventës së Gjenevës. Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet kërkesë për azil, përveç rastit kur një shtetas i huaj ose pa shtetësi kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.
4. “Aplikimi për azil” është kërkesa zyrtare, drejtuar Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.
5. “Azilkërkues” është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, i cili shpreh me çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e vet dhe ka bërë një kërkesë për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.
6. “Refugjat” është shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi që, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose kur ai, duke mos pasur një shtetësi

dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij, si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi ose nuk ka dëshirë të kthehet atje, për arsye të kësaj frike, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të konventës së Gjenevës.

7. “Statusi i refugjatit” është statusi që i jepet personit, i cili është njohur si refugjat nga organi përkatës dhe është i pranuar si i tillë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. “Të mitur të pashoqëruar” janë shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi nën 18 vjeç, të cilët vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për ta, sipas ligjit ose sipas traditës dhe për sa kohë ata nuk janë efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë. Këtu përfshihen edhe të miturit, të cilët janë lënë të pashoqëruar, pasi kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. “Mbrojtje e përkohshme” është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur nga vendet e tjera, në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku, që sistemi i azilit të jetë i paafte të procedojë me këtë fluks, pa efekte të pafavorshme në zhvillimin e tij efektiv, në interes të personave të interesuar dhe personave të tjerë që kërkojnë mbrojtje.

10. “Fluks masiv” është arritja në territorin e Republikës së Shqipërisë e një mase të madhe të personave të shpërngulur, të cilët vijnë nga një shtet apo zonë gjeografike e caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.

11. “Heqja e statusit të refugjatit” është vendimi i marrë nga organi përkatës për revokimin dhe/ose refuzimin për përtëritjen e statusit të refugjatit.

12. “Forma plotësuese e mbrojtjes” është forma e mbrojtjes, që i jepet të huajit, i cili, megjithëse nuk përmbush kriteret e të qenit refugjat, siç është shprehur në këtë nen të këtij ligji, nuk do t’i nënshtrohet asnjë urdhri dëbimi apo përzhënieje, të lëshuar nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nisur nga arsyet përkatëse, të shprehura në konventën europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” të vitit 1950, në konventat e Kombeve të Bashkuara kundër torturës, në ato për të drejtat civile dhe politike dhe çdo instrument tjetër ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është ose do të jetë palë.”.

Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Mbrojtja e përkohshme në rastet e fluksit masiv

Në rastet e një fluksi masiv të personave të huaj, që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në territorin shqiptar, procedurat e parashikuara në kreun IV të këtij ligji, për shqyrtim individual të kërkesave për azil, mund të pezullohen, duke u dhënë të gjithë personave të një grupi mbrojtje të përkohshme. Kjo mbrojtje jepet nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët për një afat të përcaktuar në vendimin që del për këtë qëllim.”.

Neni 5

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjala “refugjatit” zëvendësohet me fjalën “të huajit”.
2. Në pikën 2, fjala “refugjatë” zëvendësohet me fjalët “ose të huajve të tjerë”.
3. Në pikën 3, fjala “refugjatit” zëvendësohet me fjalën “të huajit”.

Neni 6

Në nenin 7 pika 1 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “mbrojtjes së përkohshme” zëvendësohen me fjalët “formave të tjera të mbrojtjes”.
2. Në shkronjën “c”, fjalët “mbrojtje e përkohshme, në përputhje me klauzolat e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “një nga format e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Pushimi dhe heqja e azilit

1. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin në përputhje me këtë ligj, mund t'i hiqet kjo e drejtë, si rrjedhojë e pushimit të statusit të refugjatit, në njërën nga rastet e mëposhtme:

- a) kur kërkon, me vullnetin e vet, mbrojtjen e shtetit ku gëzon shtetësinë;
- b) kur rimerr, me vullnetin e vet, shtetësinë, të cilën e kishte humbur;
- c) kur fiton një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së re;
- ç) kur rivendoset, me vullnetin e vet, në shtetin nga ku është larguar ose jashtë të cilit ka qëndruar për motive persekutimi;

d) kur kanë pushuar së ekzistuari rrethanat e parashikuara në pikën 6 të nenit 1/1 të këtij ligji dhe nuk ka arsye për të refuzuar mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së vet;

dh) kur është person pa shtetësi dhe kanë pushuar së ekzistuari rrethanat, për të cilat i është dhënë e drejta e azilit, si dhe i ka mundësitë e kushtet për t'u rikthyer në shtetin nga ku ishte larguar.

2. Përgjegjësia për mbrojtjen ndërkombëtare të personave të njohur si refugjatë, në përputhje me konventën e Gjenevës dhe protokollin e vitit 1967, në Republikën e Shqipërisë mund të vlerësohet si e transferuar në një shtet të tretë, palë në instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare, në rast se ky i fundit ka pranuar që refugjati të qëndrojë si i tillë në territorin e tij, në mënyrë të vazhdueshme dhe ka njoftuar Republikën e Shqipërisë për këtë veprim.

3. Pushimi i azilit bëhet duke zbatuar të njëjtat procedura të parashikuara edhe për dhënien e tij.

4. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin, në përputhje me pikën 6 të nenit 1/1 të këtij ligji, mund t'i hiqet kjo e drejtë, jo vetëm si rrjedhojë e pushimit të statusit të refugjatit, por edhe si dënim plotësues, i dhënë nga gjykata, për ta nxjerrë të huajin nga territori i Republikës së Shqipërisë për vepra penale, për të cilat parashikohet një dënim me jo më pak se 10 vjet heqje lirie, nga dispozitat penale në fuqi në çastin e dhënies së vendimit përfundimtar, me arsyetimin, në vendim, nga gjykata se personit, të cilit i hiqet azili, nuk do t'i kërcënohen, në vendin e vet, të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Përfashtimi nga e drejta për azil

Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi, që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga e drejta për azil, në rastin kur ka prova të mjaftueshme se:

a) kanë kryer krim kundër paqes, krim lufte apo kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare;

b) përbëjnë një rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë jopolitik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) janë fajtorë për veprime, që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.”.

Neni 9

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

**Detyrimet e azilkërkuesve dhe të personave që kanë përfituar azil
në Republikën e Shqipërisë**

1. Azilkërkuesi apo personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ndalohet të angazhohet në veprimtari të tilla, që krijojnë probleme për rendin publik, cenojnë sigurinë kombëtare dhe mund të ndikojnë në marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera.

2. Azilkërkuesi apo personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, nuk duhet të veprojë kundër parimeve dhe qëllimeve, që burojnë nga traktatet dhe konventat e OKB-së, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Azilkërkuesi duhet të japë çdo informacion, për të cilin mendohet se ai ka dijeni, kur i kërkohet nga autoritetet e azilit dhe që shërben për marrjen e një vendimi, të bazuar dhe të drejtë, për aplikimin e tij për azil.

4. Azilkërkuesi duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve të azilit gjatë të gjithë procedurës për azil.”.

Neni 10

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e dytë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Ai gëzon të gjitha të drejtat, që u njihen refugjatëve nga ky ligj dhe nga ligji nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë””.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Refugjatët, që përfitojnë të drejtën e azilit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 28 të konventës së Gjenevës, pajisen nga Ministria e Brendshme me dokument udhëtimi. Ky dokument, për aq kohë sa është i vlefshëm, mund të përdoret për të udhëtuar në të gjitha shtetet, me përjashtim të shtetit të origjinës dhe për t’u rikthyer në Shqipëri.”.

Neni 11

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Të drejtat e personave që u është dhënë mbrojtje plotësuese

Çdo i huaj, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe që i është dhënë mbrojtje plotësuese individualisht nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, përfiton të drejtat e parashikuara në këtë ligj, të cilat u jepen refugjatëve, në përputhje me konventën e Gjenevës, përveç dokumentit të udhëtimit.”.

Neni 12

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

**Të drejtat e personave, që u ofrohet mbrojtje e përkohshme, si pasojë e situatave
të flukseve masive**

Çdo i huaj, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme, si pasojë e situatave të flukseve masive, gëzon të drejtat që u jepen refugjatëve, përveçse kur ato kufizohen nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, siç është parashikuar në këtë ligj.”.

Neni 13

Në nenin 15 pika 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) e drejta e strehimit, e ushqimit, e ndihmës financiare për nevoja ngushtësisht vetjake, të ofruara në qendrën kombëtare pritëse për azilkërkuesit.”.

Neni 14

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjala “ilegalisht” zëvendësohet me fjalët “në mënyrë të paligjshme”.
2. Në shkronjën “b” të pikës 2, lidhëza “dhe” zëvendësohet me lidhëzën “ose” dhe fjala “të falsifikuara” zëvendësohet me fjalën “të rreme”.
3. Në pikën 5, fjalët “nën moshën 16 vjeç” zëvendësohen me fjalët “nën moshën 18 vjeç”.

Neni 15

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët

1. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme përbëhet nga drejtori, zëvendësdrejtori dhe të paktën tre specialistë, të cilët janë përgjegjës për regjistrimin e aplikimeve, drejtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera, të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është i vetmi autoritet për dhënien, heqjen dhe përjashtimin nga e drejta e azilit.

3. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është përgjegjëse për zbatimin e masave që duhen marrë për mbrojtjen dhe ndihmën që u ofrohet azilkërkuesve dhe refugjatëve. Autoritetet përkatëse bashkëpunojnë me Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët për zbatimin e rregullave dhe të procedurave të nevojshme për dhënien e të drejtave, që u takojnë azilkërkuesve dhe refugjatëve.

4. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët administron fondet publike, të dhëna në buxhet, si dhe ndihmat e tjera financiare ose materiale për azilkërkuesit dhe refugjatët, të ofruara nga organizatat vendase apo ndërkombëtare.

5. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është organizmi drejtues në rastet e flukseve masive dhe, nën drejtimin e drejtorit të saj, organizon punën për trajtimin e personave që u ofrohet mbrojtje e përkohshme. Ajo është përgjegjëse, në mënyrë të veçantë, për regjistrimin, sistemimin dhe shpërndarjen e ushqimeve personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme.”.

Neni 16

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “kryetari i zyrës së refugjatëve” zëvendësohen me fjalët “Drejtori i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Komisionari kombëtar për refugjatët merr të gjitha masat e nevojshme ose i drejtohet gjykatës për të caktuar, për çdo fëmijë azilkërkues të pashoqëruar apo person të rritur, me të meta mendore, një kujdestar, në përputhje me legjislacionin shqiptar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre.”.

Neni 17

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “do të shqyrtohen në mbledhjet e ardhshme të komisionit kombëtar për refugjatët” zëvendësohen me fjalët “janë paraqitur”.

2. Në pikat 3 e 4, fjalët “dhe të komisionit kombëtar për refugjatët” hiqen.

Neni 18

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1:
 - a) në shkronjën “a”, fjala “depozitojnë” zëvendësohet me fjalën “paraqesin”;
 - b) në shkronjën “b”, fjala “depozitojnë” zëvendësohet me fjalët “plotësojnë dhe” dhe pas fjalës “azil” shtohen fjalët “në përputhje me formularët e miratuar nga Ministria e Brendshme”.
2. Në pikën 2, fjala “depozitojë” zëvendësohet me fjalën “plotësojë”.

Neni 19

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1:
 - a) fjala “ adresojnë” zëvendësohet me fjalën “dërgojnë”;
 - b) fjalët “për përcaktimin e identitetit” zëvendësohen me fjalët “për të përcaktuar të dhënat personale”.
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund t’i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vërtetimin e sa më sipër. Në një rast të tillë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i kthen përgjigje Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët brenda një afati 15-ditor.”.

Neni 20

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1:
 - a) fjala “i paraqitet” zëvendësohet me fjalën “plotësohet”;
 - b) fjalët “shkaqet dhe arsyet” zëvendësohen me fjalët “dhe shkaqet”.
2. Në pikën 2, fjala “ biografike” zëvendësohet me fjalën “personale”.
3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në kohën e plotësimit të aplikimit për azil, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët vë në dijeni azilkërkuesin për procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mundëson kontaktin e azilkërkuesit me një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve, për shërbime ligjore falas.”.

Neni 21

Në nenin 24, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

- “1. Azilkërkuesi është i detyruar të bashkëpunojë për saktësimin e fakteve të parashtuara prej tij për aplikimin për azil. Ai është i detyruar:
- a) të japë informacionin e nevojshëm, gojarisht apo me shkrim, sipas kërkesës së autoriteteve të azilit;
 - b) t’u paraqesë dhe t’u dorëzojë autoriteteve përkatëse të gjitha dokumentet që disponon, të nevojshme për vlerësimin e kërkesës së tij për azil;
 - c) të jetë i kontaktueshëm, sipas kërkesës së autoriteteve dhe t’i njoftojë ato menjëherë për mundësitë e tij për të kontaktuar.”.

Neni 22

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26
Dëgjimi

1. Azilkërkuesi dëgjohe për aplikimin e tij për azil në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Azilkërkuesi njoftohet me shkrim për datën e dëgjimit, e cila nuk mund të jetë më vonë se 21 ditë nga data kur ka plotësuar aplikimin në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët.

2. Azilkërkuesi mund të pyetet për faktet dhe ngjarjet e deklaruara gjatë dëgjimit, kur ka paqartësi në ato që ka thënë ai apo në informacionet e mbledhura nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, brenda një periudhe prej jo më vonë se 20 ditësh nga data e dëgjimit. Data e dëgjimit i njoftohet me shkrim.

3. Azilkërkuesi, në çdo fazë të procedurës, shoqërohet, këshillohet apo përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve.

4. Azilkërkueset e seksit femër, nëse është e mundur, dëgjohe dhe pyeten nga punonjëse femra të personelit të Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Edhe përkthyesja, nëse është e mundur, duhet të jetë femër. Fëmijët azilkërkues, të pashoqëruar, dëgjohe dhe pyeten në prani edhe të një psikologu apo të një të rrituri, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij.

5. Azilkërkuesi shpjegon faktet, ku mbështeten arsyet dhe motivet për persekutimin e tij apo për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe ofron të dhënat e nevojshme, ku përfshihen informacioni për vendin e rezidencës, për itinerarin, ndalesat në vendet e tjera dhe kërkesat e mundshme për azil në vende të tjera, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për sqarimin e rrethanave të çështjes.

6. Dëgjimi mund të ndiqet edhe nga një përfaqësues i UNHCR-së.”.

Neni 23

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Konfidencialiteti

Dëgjimi nuk bëhet publik. Azilkërkuesit i shpjegohet detyrimi ligjor i atyre që njihen me informacionet e dhëna prej tij, për ta ruajtur informacionin si konfidencial. Atij i garantohet konfidencialiteti i dëgjimit.”.

Neni 24

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e dytë të pikës 2, fjalët “nëse shihet e arsyeshme dhe kur kërkohet nga Zyra për Refugjatët” hiqen.

2. Në pikën 3, fjalët “përcaktimet përkatëse të refugjatit, parashikuar në nenet 4, 6, 8 dhe 9” zëvendësohen me fjalët “deklarimet përkatëse të refugjatit, të marra sipas parashikimeve”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dëgjimit të azilkërkuesit dhe u jep, pa vonesë, si azilkërkuesit dhe UNHCR-së, një kopje të vendimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit. Vendimi i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët merret në një mbledhje të posaçme. Vendimi i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët jepet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar. Ai merret në mënyrë kolegjiale e, si rrjedhim, procedura e marrjes së vendimit u nënshtrohet dispozitave në fuqi për marrjen e vendimeve në organet kolegjiale. Vendimi merret me shumicë absolute votash. Pjesëtarët e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, të cilët janë në pakicë, mund ta shprehin me shkrim mendimin e tyre kundër. Ky mendim me shkrim duhet t’i bashkëlidhet vendimit përfundimtar.”.

4. Në pikën 5, fjala “revokohet” zëvendësohet me fjalën “hiqet”.

5. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

a) fjala “apelim” zëvendësohet me fjalët “ankim në organin, ku mund të paraqitet ky ankim”;

b) fjalia e dytë hiqet.

Neni 25

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Pretendimet abuzive dhe dukshëm të pabazuara

1. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund ta vlerësojë një aplikim si “abuziv”, kur është vërtetuar, në mënyrë të pakundërshtueshme, se pretendimi i bërë nga azilkërkuesi është i rremë dhe me qëllim për të mashtruar autoritetet.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund ta vlerësojë një aplikim si dukshëm të pabazuar, kur pretendimi i bërë nga azilkërkuesi nuk ka lidhje, në asnjë mënyrë, me kriteret për dhënien e azilit, siç është përcaktuar nga ky ligj.

3. Në rastet kur Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët quan se një aplikim për azil është “abuziv” apo “dukshëm i pabazuar”, ajo merr vendim të ndërmjetëm, me shkrim dhe të motivuar, i cili përfshihet në dosjen e azilkërkuesit. Kundër këtij vendimi azilkërkuesi ka të drejtë të bëjë ankim, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Si rrjedhim, do të zbatohet procedura e përsheptuar e vlerësimit të aplikimit. Nëse në fazën e parë të procedurës së përsheptuar, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët nuk jep vendim brenda 10 ditëve, aplikimi do të pranohet vetvetiu në procedurën normale të përcaktimit të statusit të refugjatit. Azilkërkuesit i jepet një afat 7-ditor për të ankimuar, nga data kur ai merr vendimin e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët.”.

Neni 26

Pas nenit 28 shtohet neni 28/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 28/1

Mosdhënia e azilit, si rrjedhojë e ardhjes nga një vend i tretë, i sigurt

Azili mund t’i mohohet çdo të huaji që vjen nga një vend i tretë, i sigurt, palë nënshkruese e konventës së Gjenevës apo protokollit të saj të vitit 1967, vend ku azilkërkuesi nuk mund të paraqesë frikë të bazuar persekutimi, për të paktën për njërën prej arsyeve të përmbajtura në nenin 1 (A) të konventës së Gjenevës, as dhe ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut apo rrezik dëbimi, në kuptimin e dispozitave të këtij ligji dhe, nëse ai mund të kthehet ligjërisht në këtë vend, ku aplikimi i tij për status refugjati do të shqyrtohet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Një listë e vendeve të treta, të sigurta, miratohet dhe përditësohet për këtë qëllim vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 27

Titulli i kreut V ndryshohet si më poshtë:

“MBROJTJA E PËRKOHSHME, SI PASOJË E SITUATAVE TË FLUKSIT MASIV”

Neni 28

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Të drejtat e të huajve që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, si pasojë e situatave të fluksit masiv

1. Të huajt, që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, si pasojë e situatave të fluksit masiv, pranohen përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.

2. Të drejtat e të huajve, që përfitojnë mbrojtje të përkohshme, veçanërisht të drejtën për punë dhe lirinë e lëvizjes, mund të kufizohen, për arsye objektive, nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët gjatë tri viteve të para të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 29

Në nenin 33, pas fjalëve “të paraqesin aplikim” shtohet fjala “individual”.

Neni 30

Shfuqizime

Nenet 2, 3, 4, 5, 10, 18 pikat 2 e 3, 19, 22 pika 3, 29, 30 e 31 shfuqizohen.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6042, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 061, datë 29.1.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË ASISTENCËS TEKNIKE, NË MBËSHTETJE TË MODERNIZIMIT TË SISTEMIT TË REGJISTRIMIT CIVIL NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për zbatimin e projektit të asistencës teknike, në mbështetje të modernizimit të sistemit të regjistrimit civil në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6043, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË ASISTENCËS TEKNIKE NË MBËSHTETJE TË MODERNIZIMIT TË SISTEMIT TË REGJISTRIMIT CIVIL NË SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje (më poshtë referuar si “Marrëveshja”) kryhet midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Brendshme (më poshtë referuar si “Ministria”) dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, përfaqësuar nga Statistic Norway (më poshtë referuar si “SN”), të dyja së bashku më poshtë referuar si “Palët”:

Neni 1

Qëllimi dhe objektivi

Kjo Marrëveshje përcakton afatet dhe procedurat për zbatimin e asistencës teknike dhe financiare të SN-së për projektin e asistencës në modernizimin e sistemit të adresave dhe regjistrimit civil në Shqipëri (më poshtë referuar si “Projekti AT”).

1. Projekti i AT është paraqitur në një dokumentprojekt për modernizimin e sistemit të regjistrimit civil në Shqipëri, hartuar nga Ministria e Brendshme dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë, në shtator 2007.

2. Kjo Marrëveshje mbulon periudhën tetor 2007-dhjetor 2008. Për arsye të rrethanave të paparashikuara, kjo periudhë mund të zgjatet.

3. Objektivi i projektit AT është të ofrojë këshillim në zhvillimin e një sistemi modern dhe të besueshëm të regjistrimit civil të popullsisë, përfshirë ngritjen e një sistemi qendror të kompjuterizuar të regjistrimit civil.

4. Mbështetja teknike e SN-së financohet nga një grant i dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (MFA) më 20 korrik 2007. Granti, prej të cilit sasia prej 3 milionë korona norvegjeze (NOK), i rezervohet blerjes së pajisjeve IT për projektin AT, është i vlefshëm deri më

gusht 2008. SN do të aplikojë pranë Ministrisë së Jashtme Norvegjeze për një tjetër grant të ngjashëm për vitin 2008.

Neni 2

Bashkëpunimi, përfaqësimi, administrimi

1. Ministria dhe SN duhet të bashkëpunojnë plotësisht në mënyrë që objektivi i projektit AT të plotësohet me sukses. Për këtë qëllim, secila palë duhet t'i ofrojë palës tjetër të gjithë informacionin që mund të kërkohej në lidhje me projektin AT.

2. SN do të ofrojë konsulentë teknikë dhe mbështetje afatshkurtër dhe afatgjatë përsa u takon çështjeve teknike.

Neni 3

Kontributet e Statistics Norway

1. SN do të ofrojë asistencë teknike për Ministrinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për çështje të tilla si: legjislacioni, infrastrukturë dhe organizim, IT, përfshirë zhvillim programi dhe blerje pajisjesh, trajnim, mbrojtje të dhënash dhe kontroll cilësie.

2. SN do të blejë pajisje IT për projektin AT, sipas specifikimeve të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Ministria e Brendshme dhe në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e projektit ATS dhe Komitetin Drejtues, brenda kufirit buxhetor të specifikuar në nenin 1.4.

Neni 4

Kontributet dhe detyrimet e Ministrisë së Brendshme

Ministria duhet të jetë përgjegjëse për zbatimin me sukses të kontributit të SN për projektin AT në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe duhet:

1. të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për planifikim, administrim dhe zbatim;
2. të ofrojë personel të mjaftueshëm lokal të kualifikuar dhe të aftë për zbatimin me sukses të projektit dhe të sigurojë që personeli i trajnuar do të mbetet në postet e tij;
3. të sigurojë përmirësimin e kushteve të punës të zyrave të gjendjes civile, përfshirë këtu furnizim pa ndërprerje me energji;
4. të bëjë të mundur aksesin e të dhënave dhe informacioneve për konsulentin afatgjatë dhe për personelin tjetër të projektit, përfshirë vizita në zyrat lokale, nëse shihet e arsyeshme, për të siguruar kështu përmbushjen me sukses të projektit AT;
5. të garantojë sigurinë e personelit në zyrat lokale dhe gjatë udhëtimeve të punës;
6. të informojë menjëherë SN-në për ndonjë rrethanë që pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin me sukses të projektit AT;
7. të asistojë përfaqësuesit e SN-së në marrjen e lejes për të vizituar secilën nga zonat e projektit për qëllime që lidhen me këtë Marrëveshje dhe në shqyrtimin e të dhënave, pajisjeve dhe dokumenteve përkatëse.

Neni 5

Prokurimi

1. SN merr përsipër të kryejë blerjet e pajisjeve dhe shërbimeve për projektin AT, sipas specifikimeve të bëra në nenet 1.4 dhe 3.2. Të gjitha prokurimet duhet të kryhen në përputhje me rregullat ekzistuese në fuqi të Qeverisë Norvegjeze për prokurimin. Marrëveshjet e prokurimit duhet të përmbajnë një klauzolë ku të parashikohet se marrëveshja do të anulohet në raste të praktikave joligjore apo korruptive në lidhje me ekzekutimin e kontratës. Nuk pranohet qoftë direkt, apo indirekt si nxitje, ose shpërblim, ose ekzekutim i marrëveshjeve të prokurimit asnjë lloj oferte, dhurate, pagese apo përfitim që mund të interpretohej si praktikë jo ligjore apo korruptive. Praktika të tilla do të përbëjnë shkak për anulimin e kësaj marrëveshjeje dhe/ose të marrëveshjes së prokurimit në fjalë.

2. Të gjithë pagimin e tatimeve dhe taksave që janë pjesë e kostos lokale, paguhen nga Qeveria, domethënë nga pala shqiptare.

Neni 6
Rezervat

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për parandalimin e korrupsionit brenda dhe nëpërmjet projektit AT. Palët angazhohen të ndërmarrin masa të shpejta ligjore në vendet e tyre përkatëse për të ndaluar, hetuar dhe ndjekur penalisht, në përputhje me ligjet kombëtare, çdo person të dyshuar për korrupsion apo për çdo keqpërdorim tjetër të burimeve.

Neni 7
Informacion, vlerësim, rishikime

1. Rishikimet e projektit duhet të kryhen me kërkesë të secilës palë.
2. SN duhet të ketë të drejtën të kryejë misione teknike ose financiare që konsiderohen të nevojshme për ndjekjen e ecurisë të projektit AT. Ministria duhet të ofrojë gjithë asistencën e nevojshme, informacionin dhe dokumentacionin përkatës, për të lehtësuar punën e personit apo personave që do të kryejnë misionin e monitorimit.

Neni 8
Mosmarrëveshje, hyrja në fuqi, përfundimi

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje për zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të bëhen konsultime midis palëve. Në rast të mosarritjes në një marrëveshje, mosmarrëveshja duhet të zgjidhet në rrugë diplomatike.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën se kanë përfunduar procedurat e brendshme të nevojshme ligjore për këtë Marrëveshje.

3. Pavarësisht klauzolës së mësipërme, palët mund t'i japin fund kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar palën tjetër me shkrim, 1 muaj para.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke vepruar në emër të institucioneve të tyre përkatëse, kanë firmosur këtë Marrëveshje në dy kopje origjinale, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën angleze, një original për secilën gjuhë dhe për secilën palë. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje për interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.10 062, datë 29.1.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN “PËR KONTROLLIN E SHKARKIMEVE TË OKSIDEVE TË AZOTIT APO FLUKSEVE TË TYRE NDËRKUFITARE”, TË KONVENTËS SË VITIT 1979 “PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6044, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI I KONVENTËS

I VITIT 1979 PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT NË
LIDHJE ME KONTROLLIN E SHKARKIMEVE TË OKSIDEVE TË AZOTIT APO FLUKSEVE
TË TYRE NDËRKUFITARE

Palët,

të vendosura për të zbatuar Konventën për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët;

të shqetësuara, nga fakti që shkarkimet aktuale të ndotësve të ajrit po shkaktojnë dëmtime të mëdha, në pjesët e ekspozuara të Europës dhe Amerikës së Veriut, ndaj burimeve natyrore me rëndësi jetike për mjedisin dhe ekonominë,

duke kujtuar se organi ekzekutiv i Konventës njohu në sesionin e saj të dytë nevojën për të reduktuar në mënyrë të efektshme shkarkimet vjetore totale të oksideve të azotit me origjinë nga burime stacionare ose të lëvizshme, apo të flukseve të tyre ndërkufitare duke filluar nga viti 1995, si dhe nevojën e shteteve të tjera që tashmë kanë bërë progres në reduktimin e këtyre shkarkimeve për të ruajtur dhe rishikuar standardet e tyre për shkarkimet e oksideve të azotit;

duke pasur parasysh të dhënat ekzistuese shkencore dhe teknike për shkarkimet, lëvizjet atmosferike dhe efektet që kanë mbi mjedisin oksidet e azotit dhe produktet e tyre dytësore, si dhe për teknologjitë e kontrollit të tyre;

të vetëdijshme për faktin që efektet dëmtoese ndaj mjedisit të shkarkimeve të oksideve të azotit ndryshojnë sipas vendeve;

të vendosura për të marrë masa të efektshme për të kontrolluar dhe për të reduktuar shkarkimet vjetore kombëtare të oksideve të azotit ose flukseve të tyre ndërkufitare, veçanërisht në sajë të zbatimit të standardeve të përshtatshme kombëtare të shkarkimit për burimet e reja të lëvizshme dhe burimet e mëdha stacionare si edhe të përshtatjes së burimeve të mëdha stacionare ekzistuese;

duke pranuar që njohuritë shkencore dhe teknike mbi këto çështje po zhvillohen dhe se do të jetë e nevojshme që këto zhvillime të merren parasysh kur të shqyrtohet vënia në zbatim e këtij protokolli si edhe të merren vendimet në lidhje me masat e mëtejshme;

duke vërejtur se zhvillimi i një qasjeje, të bazuar mbi ngarkesat kritike, synon të krijojë një bazë shkencore, e cila orientohet drejt efektit, e cila duhet të merret parasysh kur të shqyrtohet vënia në zbatim e këtij protokolli, si edhe të merren vendimet në lidhje me masat e mëtejshme të miratuara në planin ndërkombëtar që synojnë kufizimin dhe reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare;

duke pranuar që shqyrtimi i shpejtë i procedurave që synojnë të krijojnë kushte më të favorshme për shkëmbimin e teknologjive do të kontribuojë në reduktimin efektiv të shkarkimeve të oksideve të azotit në rajonin e vendeve të Komisionit;

duke vlerësuar angazhimin reciprok të ndërmarrë nga disa vende për të vënë në zbatim reduktimet e menjëhershme dhe të konsiderueshme të shkarkimeve të tyre vjetore kombëtare të oksideve të azotit;

duke njohur masat e marra tashmë nga disa vende, të cilat kanë qenë të efektshme në reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 **Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij protokollit,

1. “Konventa” është Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, e miratuar në Gjenevë më 13 nëntor 1979;

2. “EMEP-i” është programi i bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Europë;

3. “Organi ekzekutiv” është organi ekzekutiv i Konventës i krijuar sipas paragrafit të parë të nenit 10 të Konventës;

4. “Zona gjeografike e veprimit të EMEP-it” është zona e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 1 të protokollit të Konventës së vitit 1979 për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët në lidhje me financimin afatgjatë të programit të bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP), i miratuar në Gjenevë më 28 shtator 1984;

5. “Palët” janë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, palët në këtë protokoll;

6. “Komisioni” është Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën;

7. “Ngarkesa kritike” është vlerësimi sasior i ekspozimit ndaj një ose më shumë ndotësve nën të cilin, sipas dijeve aktuale, nuk ndodhin efekte dëmtoese të konsiderueshme mbi elemente veçanërisht të ndjeshme të mjedisit;

8. “Burim i madh stacionar ekzistues” është çdo burim stacionar ekzistues, prodhimi termik i të cilit është të paktën 100 MW;

9. “Burim i madh stacionar i ri” është çdo burim i ri stacionar, prodhimi termik i të cilit është të paktën 50 MW;

10. “Kategori e burimeve të mëdha” është çdo kategori e burimeve të cilat shkarkojnë ose mund të shkarkojnë ndotës të ajrit në formën e oksideve të azotit, duke përfshirë edhe kategoritë e përshkruara në shtojcën teknike dhe që kontribuojnë me të paktën 10% të totalit vjetor të shkarkimeve kombëtare të oksideve të azotit të matura ose të përlogaritura në vitin e parë kalendarik pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit dhe çdo katër vjet pas kësaj periudhe;

11. “Burim stacionar i ri” është çdo burim stacionar, ndërtimi ose modifikimi thelbësor i të cilit ka filluar pas mbarimit të afatit dy vjeçar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit;

12. “Burim i lëvizshëm i ri” është një mjet motorik ose një burim tjetër i lëvizshëm i prodhuar pas mbarimit të afatit dyvjeçar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit.

Neni 2 **Detyrimet themelore**

1. Palët duhet që, sa më shpejt të jetë e mundur dhe si një hap i parë, të marrin masa të efektshme për të kontrolluar dhe/ose reduktuar shkarkimet e tyre vjetore kombëtare të oksideve të azotit apo të flukseve të tyre ndërkufitare me qëllim që ato, jo më vonë se data 31 dhjetor 1994, të mos jenë më të mëdha se shkarkimet e tyre vjetore kombëtare të oksideve të azotit apo të flukseve të tyre ndërkufitare të vitit kalendarik 1987, ose të çdo viti tjetër të mëparshëm, i cili duhet të specifikohet në momentin e nënshkrimit apo atë të aderimit të tyre në këtë protokoll, me kusht që përveç kësaj, përsa i përket çdo pale e cila e specifikon vitin e mëparshëm, flukset mesatare vjetore ndërkufitare kombëtare ose shkarkimet e saj kombëtare mesatare vjetore të oksideve të azotit gjatë periudhës nga 1 janari i vitit 1987 deri më 1 janar të vitit 1996 të mos i tejkalojnë flukset ndërkufitare apo shkarkimet kombëtare të palës në fjalë të vitit kalendarik 1987.

2. Për më tepër, jo më vonë se dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokolli, palët, në mënyrë të veçantë:

a) duhet të zbatojnë standardet kombëtare të shkarkimeve për burimet dhe /ose kategoritë e burimeve të mëdha stacionare të reja, si edhe për burimet stacionare të modifikuara në mënyrë të konsiderueshme në kategoritë e burimeve të mëdha, të bazuara në teknologjitë më të mira të disponueshme dhe të realizueshme nga pikëpamja ekonomike, duke pasur parasysh shtojcën teknike;

b) duhet të zbatojnë standardet kombëtare të shkarkimeve të burimeve të reja të lëvizshme në të gjitha kategoritë e burimeve të mëdha, të bazuara në teknologjitë më të mira të disponueshme dhe të realizueshme nga pikëpamja ekonomike, duke pasur parasysh shtojcën teknike dhe vendimet përkatëse të marra në kuadrin e Komitetit të Transporteve Tokësore të Komisionit; dhe

c) duhet të vënë në zbatim masat e kontrollit të ndotjes për burimet e mëdha stacionare ekzistuese, duke pasur parasysh shtojcën teknike dhe karakteristikat e impiantit, kohën dhe shkallën e përdorimit të tij, si edhe nevojën për të shmangur çrregullimet e pajustifikuara gjatë funksionimit të tij.

3. a) Palët, si një hap i dytë, duhet të fillojnë bisedimet, jo më vonë se 6 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokolli, mbi masat e mëtejshme që duhen marrë në lidhje me reduktimin e shkarkimeve vjetore kombëtare të oksideve të azotit apo të flukseve ndërkufitare të këtyre shkarkimeve, duke marrë parasysh zhvillimet më të mira të disponueshme shkencore dhe teknologjike, ngarkesat kritike të pranuar në shkallë ndërkombëtare, si edhe elementet e tjera që rezultojnë nga programi i punës i hartuar në pajtim me nenin 6.

b) Për këtë qëllim, palët duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën me qëllim që të përcaktojnë:

i) ngarkesat kritike;

ii) reduktimet e nevojshme të shkarkimeve vjetore kombëtare të oksideve të azotit apo të flukseve ndërkufitare të këtyre shkarkimeve, siç kërkohen për të arritur objektivat e miratuara të bazuara mbi ngarkesat kritike; dhe

iii) masat dhe një program, duke filluar jo më vonë se 1 janari 1996, për të arritur normat e këtyre reduktimeve.

4. Palët mund të marrin masa më rigoroze se ato të përshkruara në këtë nen.

Neni 3

Shkëmbimi i teknologjisë

1. Palët duhet që, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe praktikat e tyre kombëtare, të lehtësojnë shkëmbimin e teknologjisë për reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit, veçanërisht duke promovuar:

a) shkëmbimin tregtar të teknologjisë së disponueshme;

b) kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në fushën e industrisë, duke përfshirë edhe ndërmarrjet e përbashkëta;

c) shkëmbimin e informacionit dhe përvojës, si edhe

d) sigurimin e asistencës teknike

2. Në promovimin e veprimtarive të specifikuar më sipër në nënparagrafët nga (a) deri në (d), palët duhet të krijojnë kushte të favorshme duke lehtësuar kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave dhe personave të duhur në sektorët publikë privatë, që janë në gjendje të sigurojnë teknologjinë, shërbimet e projektimit dhe të zbatimit, si edhe pajisjet apo financimet e nevojshme.

3. Palët duhet, jo më vonë se 6 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokolli, të fillojnë shqyrtimin e procedurave për të krijuar kushte më të favorshme për shkëmbimin e teknologjisë që lejojnë reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit.

Neni 4

Karburanti pa plumb

Palët duhet që, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokolli, të vënë në dispozicion karburant pa plumb në sasi të mjaftueshme, në raste të veçanta, të paktën përgjatë rrugëve kryesore të transitit ndërkombëtar, për të lehtësuar qarkullimin e mjeteve të pajisura me konvertitorë katalitikë.

Neni 5
Procesi i rishikimit

1. Palët duhet të rishikojnë periodikisht këtë protokoll, duke pasur parasysh arritjet më të mira shkencore dhe teknologjike të disponueshme.
2. Rishikimi i parë do të bëhet jo më vonë se 1 vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

Neni 6
Puna që duhet kryer

Palët duhet t'u japin prioritet të madh veprimtarive kërkimore dhe monitoruese në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e një qasjeje të mbështetur mbi ngarkesat kritike për të përcaktuar, mbi baza shkencore, reduktimet e nevojshme të shkarkimeve të oksideve të azotit. Palët duhet që, veçanërisht, nëpërmjet programeve kombëtare të kërkimit, në planin e punës të organit ekzekutiv dhe nëpërmjet programeve të tjera të bashkëpunimit të ndërmarra në kuadrin e Konventës të synojnë:

- a) identifikimin dhe përcaktimin e efekteve të shkarkimeve të oksideve të azotit mbi njeriun, botën bimore e shtazore, ujërat, tokën dhe materialet, duke marrë parasysh ndikimin mbi to të oksideve të azotit nga burimet të tjera përveç depozitimit atmosferik;
- b) përcaktimin e shpërndarjes gjeografike të zonave të ndjeshme;
- c) zhvillimin e sistemeve të matjes dhe modeleve të përlogaritjeve, duke përfshirë metodologjitë e harmonizuara për llogaritjen e shkarkimeve, me qëllim që të përcaktojnë nga pikëpamja sasiore transportin në distancë të largët të oksideve të azotit dhe ndotësve që i shoqërojnë;
- d) përmirësimin e vlerësimeve të performancës dhe kostove të teknologjive për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit dhe të regjistrojnë zhvillimin e teknologjive të reja dhe të përmirësuara; si edhe
- e) zhvillimin, në kontekstin e një qasjeje të bazuar mbi ngarkesat kritike, të metodave për integrimin e të dhënave shkencore, teknike dhe ekonomike, me qëllim që të përcaktohen strategjitë e përshtatshme të kontrollit.

Neni 7
Programet, politikat dhe strategjitë kombëtare

Palët duhet të zhvillojnë pa vonesë programet, politikat dhe strategjitë kombëtare për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky protokoll, të cilat do të shërbejnë si instrumente për kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo të flukseve të tyre ndërkufitare.

Neni 8
Shkëmbimi i informacionit dhe raportimi vjetor

1. Palët duhet të shkëmbejnë informacion duke njoftuar organin ekzekutiv për programet, politikat dhe strategjitë kombëtare që ato zhvillojnë në përputhje me nenin 7 dhe të raportojnë për këto çdo vit në lidhje me progresin e bërë dhe për çdo ndryshim të këtyre programeve, politikave dhe strategjive dhe në veçanti për:

- a) nivelet e shkarkimeve vjetore kombëtare të oksideve të azotit dhe bazën mbi të cilat janë bërë përlogaritjet e tyre;
- b) progresin e bërë në zbatimin e standardeve të shkarkimeve kombëtare të përcaktuara në nenin 2, nënparagrafët 2a dhe 2b, si edhe standardet e shkarkimeve kombëtare të zbatuara ose që do të zbatohen, si dhe burimet dhe/ose kategoritë e burimeve përkatëse;
- c) Progresin e bërë në zbatimin e masave të kontrollit të ndotjes të përshkruara në nenin 2, nënparagrafin 2a, burimet përkatëse dhe masat e miratuara ose që do të miratohen;
- d) progresin e bërë për vënien në dispozicion të karburantit pa plumb;
- e) masat e marra për të lehtësuar shkëmbimin e teknologjisë; dhe
- f) progresin e bërë në përcaktimin e ngarkesave kritike.

Neni 9
Përlllogaritjet

EMEP-i duhet që, duke përdorur modele të përshtatshme dhe në kohën e duhur para mbledhjeve vjetore të organit ekzekutiv, t'i sigurojë organit ekzekutiv përlllogaritjet e bilanceve të azotit, si edhe të flukseve e depozitimeve ndërkufitare të oksideve të azotit brenda zonës gjeografike të veprimit të EMEP-it. Në rajonet jashtë zonës gjeografike të veprimit të EMEP-it, duhet të përdoren modele të përshtatshme me rrethanat e veçanta të palëve të Konventës.

Neni 10
Shtojca teknike

Shtojca teknike e këtij protokollit ka karakter rekomandues. Ajo është pjesë përbërëse e protokollit.

Neni 11
Amendamentet e protokollit

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente të këtij protokollit.
2. Amendamentet e propozuara duhet të paraqiten me shkrim në Sekretariatin Ekzekutiv të Komisionit, i cili duhet t'ua komunikojë ato të gjitha palëve. Organi ekzekutiv duhet t'i diskutojë amendamentet e propozuara në mbledhjen e tij vjetore më të afërt, me kusht që këto propozime të kenë qarkulluar te palët nga sekretari ekzekutiv të paktën nëntëdhjetë ditë më parë.
3. Amendamentet e protokollit, përveç amendamenteve të shtojcës teknike të tij, do të miratohen me konsensus të palëve të pranishme në një nga mbledhjet e organit ekzekutiv dhe do të hyjnë në fuqi për palët që i kanë pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën dy të tretat e palëve kanë depozituar instrumentet e tyre të pranimit të këtyre amendamenteve. Amendamentet do të hyjnë në fuqi për secilën palë që i ka pranuar ato pasi dy të tretat e palëve të kenë depozituar instrumentet e tyre të pranimit të këtyre amendamenteve, ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën ajo palë ka depozituar instrumentin e vet të pranimit të amendamenteve.
4. Amendamentet e shtojcës teknike duhet të miratohen me konsensus të palëve, të pranishme në një nga mbledhjet e organit ekzekutiv dhe do të hyjnë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën ato kanë qenë komunikuar në përputhje me paragrafin 5 të mëposhtëm.
5. Amendamentet e parashikuara në paragrafët 3 dhe 4 më sipër, pas miratimit të tyre duhet t'i komunikohen nga Sekretari Ekzekutiv të gjitha palëve sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lind ndonjë mosmarrëveshje, ndërmjet dy ose me shumë palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij protokollit, ato duhet të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet bisedimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të pranueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të palëve në konflikt.

Neni 13
Nënshkrimi

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për firmosje në Sofje nga data 1 nëntor 1988 deri në datën 4 nëntor 1988, pastaj në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 5 maj 1989, nga vendet anëtare të Komisionit, si edhe për vendet që kanë statusin konsultativ në Komision, sipas paragrafit 8 të rezolutës 36 (IV) të Këshillit Ekonomik dhe Social e datës 28 mars 1947 dhe nga organizatat e integritit ekonomik rajonal, të krijuara nga shtetet sovranë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilat kanë kompetenca në drejtim të zhvillimit të negociatave, lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me çështjet që trajtohen nga ky protokoll, me kusht që shtetet dhe organizatat e interesuara të jenë palë në konventë.

2. Përsa u përket çështjeve që janë brenda kompetencave të tyre, këto organizata të integritit ekonomik rajonal duhet, që në emër të tyre, të ushtrojnë të drejtat dhe të përmbushin detyrat dhe

përgjegjësitë që cakton ky protokoll për vendet e tyre anëtare. Në raste të tilla, vendet anëtare të këtyre organizatave nuk mund t'i ushtrojnë këto të drejta individualisht.

Neni 14

Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll duhet të ratifikohet, pranohet apo miratohet nga vendet nënshkruese.
2. Ky protokoll do të jetë i hapur për aderim nga ana e shteteve dhe organizatave të përshkruara në paragrafin 1 të nenit 13, duke filluar nga data 6 maj 1989.
3. Një shtet ose një organizatë që aderon në këtë protokoll pas datës 31 dhjetor 1993 duhet të zbatojë nenet 2 dhe 4 jo më vonë se data 31 dhjetor 1995.
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose të aderimit do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e depozitarit.

Neni 15

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë duke filluar nga data kur është depozituar instrumenti i gjashtëmbëdhjetë i ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.
2. Për çdo shtet ose organizatë të përmendur në paragrafin 1 të nenit 13, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll, ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimi, miratimit apo aderimit, protokollin do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga kjo palë e aktit të saj të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.

Neni 16

Tërheqja

Në çdo moment pas pesë vjetësh, duke filluar nga data në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi për një palë të caktuar, kjo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll duke i bërë njoftim me shkrim depozitarit. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari, ose në një datë të mëvonshme siç mund të jetë specifikuar në njoftimin e palës që kërkon të tërhiqet.

Neni 17

Tekstet origjinale

Origjinali i këtij protokollin, tekstet e të cilit në anglisht, frëngjisht dhe rusisht, janë njëlloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit a autorizuar ligjërish kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Sofje më 31 tetor 1989.

SHTOJCA TEKNIKE

I. TEKNOLOGJITË E KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA BURIMET STACIONARE

II. TEKNOLOGJITË E KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA BURIMET E LËVIZSHME

1. Qëllimi i kësaj shtojce është të sigurojë udhëzime për palët e Konventës në lidhje me identifikimin e alternativave dhe teknikave të kontrollit të oksideve të azotit në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas protokollit.

2. Shtojca mbështetet në informacionin mbi alternativat dhe teknikat për reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit, si edhe mbi performancën dhe kostot e tyre që gjenden në dokumentacionin e organit ekzekutiv dhe organeve vartëse të tij dhe në dokumentacionin e Komitetit

të Transportit Tokësor të KEE-së dhe të organeve vartëse të tij dhe në informacionin plotësues të siguruar nga ekspertë të caktuar nga qeveria.

3. Shtojca trajton kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit (NO_x) të menduar si shuma e oksidit të azotit (NO) dhe dyoksideve të azotit NO_2 të shprehura si NO_2 dhe rendit një numër masash dhe teknikash të reduktimit të oksideve të azotit (NO_x) duke përfshirë një diapazon të gjerë të kostove dhe shkallës së efektshmërisë. Për sa kohë nuk ka mendime të kundërta, këto teknika konsiderohen të jenë krijuar mirë mbi bazën e përvojës funksionale, e cila në pjesën më të madhe të rasteve ka qenë fituar për një periudhë pesëvjeçare ose më shumë. Megjithatë kjo gjë nuk duhet konsideruar si një paraqitje shteruese e mundësive të kontrollit; qëllimi i tij është të sigurojë udhëzime për palët në lidhje me identifikimin e teknologjive më të mira të disponueshme të cilat janë ekonomikisht të realizueshme si një bazë për standardet kombëtare të shkarkimeve, si edhe në futjen e masave të kontrollit të ndotjes.

4. Zgjedhja e masave të kontrollit të ndotjes për çdo rast të veçantë do të varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë dispozitat ligjore dhe rregullatore, modelin e energjisë parësore, infrastrukturën industriale dhe rrethanat ekonomike të palëve të interesuara dhe në rastin e burimeve stacionare, rrethanat specifike të fabrikës. Duhet pasur parasysh gjithashtu se burimet e oksideve të azotit NO_x shpesh shërbejnë edhe si burime për ndotës të tjerë, si për shembull oksidet e squfurit (SO_x), përbërjet organike shpërthyes dhe grimcat. Gjatë projektimit të varianteve të kontrollit për këto burime, të gjitha shkarkimet ndotëse duhet të merren parasysh së bashku, me qëllim që të arrihet maksimizimi i efektit të përgjithshëm të reduktimit, si edhe të minimizohet ndikimi që ky burim ka mbi mjedisin.

5. Shtojca reflekton gjendjen e njohurive dhe të përvojës në lidhje me masat e kontrollit të oksideve të azotit NO_x , duke përfshirë përshtatjen e mëvonshme, çka u arrit në vitin 1992, në rastin e burimeve stacionare dhe në vitin 1994 në rastin e burimeve të lëvizshme. Meqenëse përvoja dhe njohuritë zgjerohen vazhdimisht, veçanërisht me mjetet e vogla motorike, të cilat shoqërohen nga një teknologji me më pak shkarkime dhe zhvillimin e lëndëve djegëse alternative, si edhe me përshtatjet e mëvonshme dhe strategjitë e tjera për mjete ekzistuese, shtojca ka nevojë të përditësohet dhe të përmirësohet vazhdimisht.

1. TEKNOLOGJITË E KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NO_x NGA BURIMET STACIONARE

6. Djegia e lëndëve djegëse fosile nga burimet stacionare është burimi kryesor i shkarkimeve me natyrë antropogjenike të oksideve të azotit. Përveç kësaj, disa procese pa djegie mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme tek shkarkimet. Kategoritë e mëdha të burimeve stacionare të shkarkimeve të oksideve të azotit, të bazuara në EMEP/CORINAIR 90, përfshijnë:

a) centralet elektrike publike, proceset e prodhimit të kombinuar nxehtësi-elektricitet dhe instalimet e ngrohjes urbane:

i) kaldajat;

ii) turbinat stacionare me djegie dhe motorët me djegie të brendshme;

b) instalimet tregtare, institucionale dhe rezidenciale të djegies:

i) kaldajat tregtare;

ii) aparatet e ngrohjes shtëpiake;

c) instalimet industriale të djegies dhe proceset me djegie:

i) kaldajat dhe furrat e ngrohjes (pa kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet fluksit të gazit dhe produkteve);

ii) proceset me kontakt të drejtpërdrejtë, (për shembull procesi i pjekjes në furrat me sistem qarkullimi, prodhimi i çimentos, gëlqeres, etj., prodhimi i qelqit, prodhimi i brumit të letrës, proceset metalurgjike);

d) proceset pa djegie, për shembull prodhimi i acidit nitrik;

e) nxjerrjen, përpunimin dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse fosile;

f) Përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve, për shembull djegien e mbetjeve urbane dhe industriale.

7. Për rajonin e KEE-së, proceset me djegie: (kategoritë (a), (b), dhe (c) përbëjnë 85% të shkarkimeve të oksidit të azotit NO_x me origjinë burimet stacionare. Proceset pa djegie, për shembull proceset e prodhimit, përbëjnë 12%, ndërsa nxjerrja, përpunimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse

fosile përbëjnë 3% të totalit të shkarkimeve të oksidit të azotit NO_x. Megjithatë në shumë vende të KEE-së centralët elektrike të kategorisë (a) janë kontribuuesit stacionarë më të mëdhenj të shkarkimeve të oksideve të azotit NO_x, trafiku rrugor është zakonisht i vetmi burim më i madh i shkarkimeve të oksideve të azotit NO_x, por shpërndarja ndryshon shumë ndërmjet palëve të Konventës. Duhet pasur parasysh gjithashtu edhe burimet industriale.

ALTERNATIVAT KRYESORE PËR REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE TË OKSIDEVE TË AZOTIT NO_x NGA DJEGIA

8. Alternativat kryesore për pakësimin e oksideve të azotit NO_x janë:

a) masat për administrimin e energjisë¹:

i) kursimi i energjisë;

ii) përzierja e energjisë;

b) alternativat teknike:

i) zëvendësimi/pastrimi i lëndëve djegëse;

ii) teknika të tjera të djegies;

iii) ndryshime të proceseve dhe të mënyrës së djegies;

iv) trajtimi i gazeve të oxhakut.

9. Për të realizuar programin më efikas të reduktimit të oksideve të azotit, përveç masave të përmendura në (a), duhet të merret parasysh gjithashtu edhe kombinimi i alternativave teknike të identifikuar në (b). Për më tepër, kombinimi i ndryshimit të mënyrës së djegies dhe trajtimi i gazeve të oxhakut kërkon një vlerësim specifik në terren.

10. Në disa raste, alternativat për të reduktuar shkarkimet e oksideve të azotit mund të rezultojnë edhe në reduktimin e shkarkimeve të dyoksideve të karbonit dhe dyoksideve të squfurit si edhe të atyre të ndotësve të tjerë.

Kursimi i energjisë

11. Përdorimi racional i energjisë (përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe i funksionimit të proceseve, procesi i prodhimit të kombinuar nxehtësi-elektricitet dhe/ose administrimi i kërkesës) zakonisht çojnë në një reduktim të shkarkimeve të oksideve të azotit.

Përzierja e energjisë

12. Në përgjithësi, shkarkimet e oksideve të azotit mund të reduktohen duke rritur raportin mes burimeve të energjisë pa djegie (për shembull të atyre hidrike, bërthamore, të erës, etj.) dhe energjisë së përzier. Sidoqoftë, duhen marrë parasysh ndikimet e mëtejshme mjedisore.

Zëvendësimi/pastrimi i lëndëve djegëse

13. Tabela 1 tregon nivelet e shkarkimeve të pakontrolluara të oksideve të azotit që priten gjatë djegies së lëndës djegëse fosile për sektorë të ndryshëm.

14. Zëvendësimi i lëndëve djegëse (për shembull nga lëndë djegëse me përmbajtje më të lartë azoti në ato me përmbajtje më të ulët, ose nga qymyri në gaz) mund të çojë në shkarkime më të vogla të oksideve të azotit, por mund të ketë disa pengesa, si për shembull sigurimi i lëndëve djegëse që shkarkojnë pak oksid azoti, (për shembull gazi natyror tek uzinat) dhe përshtatshmëria e furrave ekzistuese ndaj lëndëve djegëse të ndryshme me përmbajtje oksid azoti. Në shumë vende të KEE-së, disa impiante që përdorin djegien me qymyr ose me naftë janë zëvendësuar me impiante djegieje me gaz.

15. Heqja e azotit që gjendet në lëndën djegëse nuk është akoma një alternativë me leverdi ekonomike. Rritja e zbatimit të teknologjisë së krek-ing-ut të naftës te rafineritë sjell gjithashtu një reduktim të përmbajtjes së azotit në produktin përfundimtar.

Teknologjitë e tjera të djegies

16. Këto janë teknologjitë e djegies me efikasitet termik të përmirësuar dhe shkarkime të reduktuara të oksideve të azotit. Ato përfshijnë:

a) prodhimin e kombinuar nxehtësi-elektricitet duke përdorur turbinat dhe motorët me gaz;

¹ Alternativat (a) (i) dhe (ii) janë të përfshira në strukturën dhe politikën energjitike të një pale. Shkalla e zbatimit, efektshmërisë dhe shpenzimeve të tyre sipas sektorëve nuk janë shqyrtuar në këtë pjesë.

- b) djegien me shtrat të lëngët, me shtrat flluskues dhe me shtrat qarkullues;
- c) ciklin e kombinuar me gazifikim të integruar;
- d) turbinat me gaz për ciklin e kombinuar;

17. Nivelet e shkarkimeve për këto teknika jepen të përmbledhura në tabelën 1.

18. Turbinat me djegie fikse mund të jenë të integruara gjithashtu edhe në centralet elektrike tradicionale, gjë që lejon përmirësimin e rendimentit të përgjithshëm nga 5 deri 6%, por arritja e reduktimit të oksideve të azotit varet nga karakteristikat e vendit dhe të lëndës djegëse. Turbinat dhe motorët me gaz përdoren gjerësisht për prodhimin e përzier. Si rregull i përgjithshëm, kursimi i energjisë mund të arrijë rreth 30%. Në të dy rastet, zbatimi i koncepteve të reja për teknikat e djegies dhe teknologjitë e sistemeve ka lejuar të reduktohen ndjeshëm shkarkimet e oksideve të azotit. Megjithatë ky integrim kërkon një modifikim të plotë të sistemeve ekzistuese të kalidajave.

19. Djegia me shtrat të lëngët është një teknologji djegieje e përshtatshme për djegien e antracitit dhe linjiteve, por mund të përdoret gjithashtu për lëndët e tjera të djegshme të ngurta, si koksi i naftës dhe me lëndët djegëse të varfra (mbeturinat, torfet dhe drurin). Përveç kësaj, shkarkimet mund të reduktohen me anë të kontrollit të integruar të djegies në sistem. Një koncept më i ri i djegies me shtrat të lëngët është djegia në shtrat të lëngët nën presion që është aktualisht në treg për prodhimin e elektricitetit dhe të nxehtësisë. Fuqia e instaluar totale në djegien me shtrat të lëngët ka arritur rreth 30 000 MWth (250 deri 350 impiante), nga të cilat 8 000 MWth kanë kapacitet më të madh se 50 MWth.

20. Procesi i ciklit të kombinuar me gaz të integruar përfshin gazifikimin e qymyrit dhe prodhimin e elektricitetit me cikël të kombinuar në turbinën me gaz dhe me avull. Qymyri i gazifikuar digjet në dhomën e djegies së turbinës me gaz. Kjo teknologji zbatohet gjithashtu me mbetjet e vajrave të rënda dhe me emulsionet bituminoze. Fuqia e instaluar është aktualisht rreth 1000 MWel (5 impiante).

21. Aktualisht janë duke u studiuar centralet me gaz me cikël të kombinuar që shkarkojnë më pak oksid azoti dhe që funksionojnë me turbina të avancuara me gaz dhe një rendiment energjetik prej 48-52 %.

Modifikimet e proceseve dhe të djegies

22. Këto janë masat e zbatuara gjatë djegies për të reduktuar formimin e oksideve të azotit. Masat përfshijnë kontrollin e raportit të djegies në ajër, temperaturën e flakës, raportin lëndë djegëse/ajër, etj. Teknikat e mëposhtme të djegies mund të përdoren, veçmas ose të kombinuara, në impiantet e reja ose ato ekzistuese. Ato janë shumë të përhapura në sektorin e centraleve elektrike si edhe në disa fusha të sektorit industrial:

- a) djegia me tepricë të vogël në ajër²;
- b) parangrohja e reduktuar e ajrit 2 ;
- c) djegësi jashtë shërbimit 2;
- d) ndezja e polarizuar e djegësit 2;
- e) djegës me shkarkim të vogël të oksideve të azotit 2 ³
- f) riqarkullimi i gazeve të oxhakut 3;
- g) djegia e ajrit sipër zjarrit 2 dhe 3;
- h) ridjedia me reduktim të oksideve të azotit në furrë⁴;
- i) injektimi avull/ujë dhe përdorimi i kombinuar i lëndëve djegëse të varfra të përziera paraprakisht⁵

23. Nivelet e shkarkimeve që rezultojnë nga zbatimi i këtyre teknikave (të llogaritura kryesisht duke u bazuar në përvojën e centraleve elektrike) jepen në tabelën 1.

24. Ndryshimet e mënyrës së djegies janë vazhdimisht objekt i studimeve dhe i masave të përmirësimit. Reduktimi i oksideve të azotit në furrë është duke u testuar në disa impiante që përdoren për demonstrime në shkallë të gjerë, ndërsa ndryshimet kryesore të mënyrës së djegies janë kryesisht të përfshira në konceptimin e kalidajave dhe të djegësve. Për shembull, modelet e furrave moderne përfshijnë të çara për djegie me ajër shtesë dhe djegësit me gaz / naftë janë të pajisur me një sistem të

² Masat e ripërshtatjes tipike, me rendiment të ulët dhe zbatueshmëri të kufizuar.

³ Teknologjia e kohëve të fundit më e përparuar që përdoret në impiantet e reja.

⁴ E zbatuar në impiantet e mëdha industriale, përvoja funksionale është akoma e kufizuar.

⁵ Për turbinat me djegie me gaz

riqarkullimit të gazeve të oxhakut. Brezi i fundit i djegësve me shkarkim të vogël të oksideve të azotit kombinon përqendrimin e ajrit dhe përqendrimin e lëndës djegëse. Këto vitet e fundit, ripërshtatja e plotë e impianteve për të futur ndryshimet e arritura në mënyrën e djegies është rritur shumë në vendet anëtare të KEE-së. Në 1992, fuqia e instaluar arriti në rreth 150.000 MW.

Proceset e trajtimit të gazeve të oxhakut

25. Proceset e trajtimit të gazeve të oxhakut kanë për qëllim që të largojnë oksidin e azotit të formuar më parë, të cilave u referohemi si masa dytësore. Kudo ku është e mundur, është mjaft e zakonshme të zbatohen masat parësore si një fazë e parë e reduktimit të oksideve të azotit, para se të vihen në veprim proceset e trajtimit të gazeve të oxhakut. Proceset më moderne të trajtimit të gazeve të oxhakut bazohen të gjitha tek largimi i oksideve të azotit me anën e proceseve kimike jo të lëngët.

26. Bëhet fjalë për proceset e mëposhtme:

- a) reduktimin katalitik selektiv;
- b) reduktimin jo katalitik selektiv;
- c) proceset e largimit të kombinuar të oksideve të azotit dhe atij të squfurit;
- i) procesin me karbon të aktivizuar;
- ii) largimin katalitik të kombinuar të oksideve të azotit dhe oksideve të squfurit.

27. Nivelet e shkarkimeve që rezultojnë nga zbatimi i teknikave të reduktimit katalitik dhe jo katalitik selektiv jepen në tabelën 1. Të dhënat bazohen te përvoja praktike e fituar në një numër të madh impiantesh në funksionim. Deri në vitin 1991, në pjesën europiane të KEE-së ishin ndërtuar rreth 130 impiante për reduktimin katalitik selektiv me një vlerë totale prej 50.000 MWel, 12 impiante për reduktim jo katalitik selektiv (2.000 MWel); një implant me karbon të aktivizuar (250 MWel) dhe dy procese katalitike të kombinuara (400 MWel). Rendimenti i largimit të oksideve të azotit me karbon të aktivizuar dhe i proceseve katalitike të kombinuara është i krahasueshëm me atë të reduktimit katalitik selektiv.

28. Tabela 1 jep gjithashtu në mënyrë të përmbledhur shpenzimet e zbatimit të teknologjive të reduktimit të oksideve të azotit.

TEKNIKAT E KONTROLLIT PËR SEKTORËT E TJERË

29. Ndryshe nga shumica e proceseve të djegies, zbatimi i modifikimeve të arritura në mënyrën e djegies dhe/ose tek proceset në sektorin industrial shoqërohet me shumë kufizime specifike të proceseve. Në furrat e çimentos dhe furrat e shkrirjes së qelqit, për shembull, duhen temperatura të larta për të siguruar cilësinë e produktit. Modifikimet më tipike të mënyrës së djegies janë futja e djegësve me djegie të përqendruar që shkarkojnë pak oksid azoti, riqarkullimi i gazeve të oxhakut dhe optimizimi i procesit (parakalifikimi në furrat e çimentos, etj.).

30. Tabela 1 jep disa shembuj.

EFEKTET ANËSORE / NËNPRODUKTET

31. Efektet anësore të mëposhtme nuk e pengojnë zbatimin e ndonjë teknologjie ose metode, por duhet të merren parasysh kur janë të mundshme të zbatohen shumë alternativa të reduktimit të oksideve të azotit. Megjithatë, në përgjithësi një konceptim i mirë dhe një funksionim i përshtatshëm do të mund t'i kufizonte këto efekte:

a) Modifikimet e mënyrës së djegies:

- ulja e mundshme e rendimentit të përgjithshëm;
- shtimi i krijimit të oksideve të karbonit dhe i shkarkimeve të hidrokarbureve;
- gërryerja (korrozioni) e shkaktuar nga efekti reduktues i atmosferës;
- formim i mundshëm i N_2O në sistemet e djegies me shtrat të lëngët;
- rritja e mundshme e hirit fluturues të qymyrit.

b) Reduktimi katalitik selektiv:

- prania e NH_3 në hiri fluturues;
- formimi i kripërave të amonit në impiantet dytësore;
- çaktivizimi i katalizatorit;
- shndërrimi në rritje i SO_2 në SO_3 ;

c) Reduktimi jo katalitik selektiv:

- prania e NH_3 në hiri fluturues;

- formimi i kripërave të amonit në impiantet dytësore;
- formimi i mundshëm i N_2O ;

32. Për sa u përket nënprodukteve, katalizatorët e çaktivizuar të procesit të reduktimit katalitik selektiv janë të vetmet produkte që mund të merren parasysh. Për shkak të klasifikimit të tyre si mbetje, nuk lejohet depozitimi i tyre i thjeshtë; megjithatë ekzistojnë mundësi për t'i ricikluar.

33. Prodhimi reagent i amoniakut dhe uresë për proceset e trajtimit të gazeve të oxhakut përfshin një sërë fazash të veçanta që kërkojnë energji dhe substanca që hyjnë në reaksion. Sistemet e ruajtjes së amoniakut i nënshtrohen legjislacionit përkatës të sigurisë dhe janë projektuar të tilla për të funksionuar si sisteme plotësisht të mbyllura, çka redukton në minimum shkarkimet e amoniakut. Megjithatë përdorimi i NH_3 nuk paraqet probleme edhe sikur të marrim parasysh shkarkimet jo të drejtpërdrejta që lidhen me prodhimin dhe transportin e tij.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

34. Masat e marra nga vendet për të zbatuar strategjitë dhe politikat e tyre të pakësimit të ndotjes së ajrit përfshijnë dispozita legjislative dhe rregulluese, nxitës, dhe frenuese ekonomike, si edhe kërkesa teknologjike (teknologjinë më të mirë të disponueshme).

35. Përsa u përket shkarkimeve të përgjithshme, mund të caktohen standarde të kufizimit të shkarkimeve nga burimet e shkarkimit në funksion të madhësisë së impiantit, mënyrës së funksionimit, teknologjisë së djegies, llojit të lëndës djegëse dhe të faktit nëse impianti është i ri ose ekzistues. Një qasje tjetër alternative që përdoret ka të bëjë me përcaktimin e një objekti për reduktimin e shkarkimeve totale të oksideve të azotit nga një grup burimesh ekzistuese dhe t'i japë mundësi palëve të zgjedhin se ku duhet të ndërhyjnë për ta arritur këtë objektiv (koncepti i fluskës).

36. Kufizimi i shkarkimeve të oksideve të azotit te nivelet e përcaktuara në legjislacionin kuadër kombëtar duhet t'i nënshtrohet një sistemi të përhershëm monitorimi dhe raportimi dhe rezultatet duhet t'u komunikohen autoriteteve mbikëqyrëse.

37. Aktualisht ekzistojnë disa sisteme monitorimi, të cilat përdorin si metodat e matjes së vazhdueshme, ashtu edhe ato të matjes me ndërprerje. Megjithatë, kërkesat e cilësisë ndryshojnë nga njëri vend palë në një tjetër. Matjet duhet të kryhen nga institute të kualifikuara dhe me anën e sistemeve të matjes/monitorimit të miratuara. Për këtë qëllim, një sistem i certifikuar do të jepte garancinë më të mirë.

38. Në kuadrin e sistemeve moderne të monitorimit automatik dhe pajisjeve moderne të kontrollit të procesit, raportimi i të dhënave nuk paraqet probleme. Grumbullimi i tyre për një përdorim të mëtejshëm kërkon teknika moderne. Megjithatë, të dhënat për t'iu komunikuar autoriteteve kompetente ndryshojnë nga një palë në tjetrën. Për të përmirësuar krahasueshmërinë e të dhënave, do të duhet të harmonizohen seritë e të dhënave dhe rregullat e parashikuara. Harmonizimi është gjithashtu i dëshirueshëm për të siguruar cilësinë e sistemeve të matjes/monitorimit. Kjo duhet marrë parasysh kur krahasohen të dhënat që vijnë nga palë të ndryshme.

39. Për të shmangur mospërputhjet dhe të dhënat jo të krahasueshme duhet të përcaktohen mirë elementet dhe parametrat kryesorë dhe veçanërisht:

- Standardet duhet të jenë të shprehura në ppmv, mg/m^3 , g/GJ, kg/h ose kg/t të produkteve. Shumica e këtyre njësive duhet të llogariten dhe të specifikohen për temperaturën e gazit, lagështinë, trysinë, përmbajtjen e oksigjenit dhe vlerën e përdorur të nxehtësisë.

- Është e rëndësishme të përcaktohet intervali i kohës së duhur për të shprehur standardet si mesatare në orë, muaj, vite.

- Duhet të përcaktohet kohëzgjatja e defekteve dhe rregulloret përkatëse të urgjencave për të lidhur sistemet e monitorimit ose mbylljen e impiantit.

- Duhet të përcaktohen metodat që japin mundësi të plotësohen të dhënat që mungojnë ose kanë humbur si rezultat i mosfunksionimit të pajisjes.

- Ka rëndësi të përcaktohet seria e parametrave për t'u matur. Të dhënat e nevojshme mund të ndryshojnë në varësi të llojit të procesit industrial. Kjo përfshin gjithashtu përcaktimin e vendndodhjes së pikës së matjes brenda sistemit.

40. Kontrolli i cilësisë së matjeve duhet të jetë i garantuar.

TEKNOLOGJITË E KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA BURIMET E LËVIZSHME

BURIMET E MËDHA TË LËVIZSHME TË OKSIDEVE TË AZOTIT

41. Burimet e mëdha të lëvizshme të shkarkimeve të oksideve të azotit me origjinë antropogjenike janë:

Për sa u përket automjeteve:

- makinat e pasagjerëve me benzinë dhe me naftë;
- mjetet e lehta motorike për tregti;
- mjetet e rënda motorike;
- motoçikletat dhe çiklomotorët;
- traktorët (për bujqësi dhe pyje).

Për sa u përket mjeteve me përdorim jo në rrugë:

- Makineritë bujqësore, industriale (të lëvizshme) dhe të ndërtimit.

Për sa u përket burimeve të tjera të lëvizshme:

- Transporti hekurudhor;
- Anijet dhe mjetet e tjera të lundrimit;
- Aeroplanët.

42. Transporti rrugor përbën një burim të rëndësishëm të shkarkimeve të oksideve të azotit me origjinë antropogjenike në shumë vende të KEE-së, ku mund të zënë deri në dy të tretat e shkarkimeve totale kombëtare. Në disa vende, makinat me benzinë zënë dy të tretat e shkarkimeve totale kombëtare të oksideve të azotit me origjinë qarkullimin rrugor. Megjithatë, në një numër të vogël rastesh, shkarkimet e oksideve të azotit nga mjetet e rënda motorike janë më të larta se sa të veturave të pasagjerëve, të cilat janë në ulje të vazhdueshme.

43. Shumë vende kanë miratuar rregullore që kufizojnë shkarkimet e ndotësve nga automjetet. Për mjetet jorrugore janë miratuar nga disa shtete të KEE-së standarde shkarkimesh, duke përfshirë edhe ato të oksideve të azotit dhe janë duke u përgatitur në vetë KEE-në. Shkarkimet e oksideve të azotit nga këto burime të tjera mund të jenë në sasi të konsiderueshme.

44. Derisa të dhëna të tjera të bëhen të disponueshme, kjo shtojcë do të përqendrohet vetëm tek automjetet.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË TEKNOLOGJISË SË KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA AUTOMJETET

45. Automjetet e marra në shqyrtim në këtë shtojcë janë makinat e pasagjerëve, mjetet e lehta motorike për tregti, motoçikletat, çiklomotorët dhe mjetet e rënda motorike.

46. Të gjitha automjetet, të reja ose jo, janë marrë parasysh, por kjo shtojcë merret veçanërisht më shumë me reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit të tipave të reja të automjeteve.

47. Shifrat e shpenzimeve për teknologjitë e ndryshme të dhëna janë shpenzimet e pritshme të prodhimit dhe jo çmimet e shitjes me pakicë të tyre.

48. Është e rëndësishme të sigurohet që standardet e shkarkimeve, për automjetet e reja të ruhen edhe gjatë përdorimit. Kjo mund të arrihet nëpërmjet programeve të inspektimit dhe të mirëmbajtjes, duke siguruar përputhjen e prodhimit dhe qëndrueshmërinë e tyre gjatë gjithë kohës së përdorimit, duke garantuar komponentët e kontrollit të shkarkimeve si edhe duke pasur parasysh automjetet defektive.

49. Nxitësit fiskalë mund të nxisin përshpejtimin e futjes së teknikave të reja. Përshtatja e automjeteve tashmë në përdorim paraqet pak interes për reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit dhe mund të jetë e vështirë të aplikohet në një përqindje të madhe të gamës të automjeteve.

50. Teknologjitë që përfshijnë motorët me benzinë të pajisur me konvertitorë katalitikë kërkojnë detyrimisht përdorimin e karburantit pa plumb, i cili duhet të vihet gjerësisht në dispozicion. Për motorët diesel (me naftë), përdorimi i teknologjive të trajtimit të mëtejshëm, si për shembull katalizatorët me oksidim ose filtrat e lëndës së grimcuar, kërkojnë përdorimin e karburanteve me përmbajtje të ulët squfuri (jo më të lartë se 0,05%).

51. Rregullimi i qarkullimit urban dhe në distancë të largët, i cili nuk trajtohet në këtë shtojcë, është mjaft i rëndësishëm si një nga qasjet më efikase shtesë të kontrollit të shkarkimeve, duke përfshirë edhe oksidet e azotit. Masat që merren për të reduktuar këto të fundit, si edhe shkarkimet e ndotësve të tjerë të ajrit, mund të përfshijnë kufizimin e shpejtësisë së qarkullimit dhe të sigurojnë një

rregullim efikas të qarkullimit. Masa të tjera të rëndësishme për rregullimin e trafikut synojnë të ndryshojnë ndarjen e mjeteve të transportit në ato për transport publik dhe për transport në distancë të largët, veçanërisht në zonat e ndjeshme si qytetet ose Alpet, duke kaluar nga transporti rrugor në atë hekurudhor nëpërmjet elementeve të natyrës teknike, strukturore, financiare dhe rregulluese, si dhe nëpërmjet përmirësimit të logjistikës së sistemeve të transportit. Ato do të sigurojnë gjithashtu edhe përfitime nga efektet e tjera të dëmshme të zgjerimit të trafikut, të tilla si zhurma, trafiku i rënduar etj.

52. Ekziston një gamë e madhe teknologjish dhe alternativa modelesh për të mundësuar kontrollin e njëkohshëm të ndotësve të ndryshëm. Në disa zbatime, reduktimi i shkarkimeve të oksideve të azotit shoqërohet me efekte të kundërta (për shembull motorët diezel (me naftë) ose me benzinë pa katalizator). Përdorimi i teknologjive të reja (për shembull i pajisjeve të pastrimit të mëtejshëm ose elektronike) mund ta ndryshojë situatën. Karburantet e reja për motorët diezel (me naftë) ose me benzinë që përmbajnë elemente shtesë për reduktimin e përmbajtjes së oksideve të azotit të gazeve të skapamentos gjithashtu mund të luajnë rol në strategjitë për reduktimin e shkarkimeve të oksideve të azotit nga makinat me motor diezel (me naftë).

TEKNOLOGJITË E KONTROLLIT PËR SHKARKIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA AUTOMJETET

Veturat dhe mjetet e lehta motorike për tregti me benzinë dhe me motor diezel(me naftë)

53. Tabela 2 paraqet teknologjitë kryesore për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit.

54. Baza për krahasim në tabelën 2 është teknologjia alternative B, që paraqet modelet jo katalitike të projektuara në mbështetje të kërkesave të përcaktuara nga Shtetet e Bashkuara për vitin 1973/1974 ose me rregulloren 15-04 të KEE-së⁶ e cila është në pajtim me Marrëveshjen e vitit 1958 që ka të bëjë me Miratimin e Kushteve të Njëjta të Aprovimit dhe të Njohjes Reciproke të Aprovimit të Pajisjeve dhe Pjesëve të Këmbimit të Mjeteve Motorike. Tabela paraqet gjithashtu edhe nivelet karakteristike të shkarkimeve në rast të kontrollit të katalizatorëve tre-funksionalë ose të katalizatorëve me oksidim dhe jep shpenzimet përkatëse.

55. Niveli (A) “i pakontrolluar” i referohet situatës në vitin 1970 për rajonin e KEE-së, por mund të mbizotërojë ende në disa zona.

56. Nivelet e shkarkimit të paraqitura në tabelën 2 reflektojnë vlerat e shkarkimeve të matura me anën e procedurave standarde të testimeve. Shkarkimet nga mjetet rrugore mund të ndryshojnë për shkak të ndikimit, ndërmjet të tjerave, të temperaturës së mjedisit, kushteve të përdorimit (veçanërisht shpejtësia më e madhe), vetive të karburantit, si edhe shkallës së mirëmbajtjes. Sidoqoftë, potenciali i reduktimit i treguar në tabelën 2 konsiderohet si përfaqësues i reduktimeve të arritshme gjatë përdorimit.

57. Teknologjia më efikase aktuale e disponueshme e reduktimeve të shkarkimeve të oksideve të azotit është alternativa E. Kjo teknologji bën të mundur arritjen e reduktimit në masë të madhe të shkarkimeve të oksideve të azotit, të atyre të përbërjeve organike shpërthyes, si edhe të shkarkimeve të oksideve të karbonit.

58. Në mbështetje të programeve rregulluese për reduktimin e mëtejshëm të shkarkimeve të oksideve të azotit (për shembull shkarkimet në nivele të ulëta nga automjetet në Kaliforni), po zhvillohen sistemet e reja të përparuara me katalizator trefunksional (alternativa F). Këto përmirësime do të përqendrohen tek funksionimi i motorit, kontrolli shumë i saktë i raportit ajër-karburant, ngarkesa më të madhe e katalizatorit, sistemet e diagnostikimit brenda në automjet, si edhe tek masa të tjera moderne kontrolli.

Motoçikletat dhe çiklomotorët

59. Megjithëse shkarkimet aktuale të oksideve të azotit nga motoçikletat dhe çiklomotorët janë shumë të vogla (për shembull në rastin e motoçikletave me dy kohë), ato nuk duhen neglizhuar. Ndërkohë që shkarkimet e përbërjeve organike shpërthyes janë duke u kufizuar nga shumica e vendeve palë të konventës, shkarkimet e tyre të oksideve të azotit mund të rriten (për shembull me përdorimin e motorëve me katër kohë). Në përgjithësi, edhe këtu janë të zbatueshme të njëjtat alternativa teknologjike të përshkruara për automjetet e pasagjerëve me benzinë. Austria dhe Zvicra

⁶ E cila është zëvendësuar nga Rregullorja nr.83

tashmë po zbatojnë standarde më të rrepta në lidhje me shkarkimet e oksideve të azotit.

Mjetet e rënda të përdorimit me motor diesel

60. Tabela 3 përmbledh tri alternativa teknologjike. Modeli bazë është motori diesel me turbokompresor. Prirja është drejt motorëve turbokompresorë me shkëmbyes të ndërmjetëm, sistemet e përparuara të injektimit të karburantit dhe kontrollit elektronik. Kjo prirje mund të ofrojë potencialin e përmirësimit të performancës së konsumit standard të karburantit. Ajo nuk përfshin vlerësime të krahasueshme të konsumit të karburantit.

TEKNIKAT E KONTROLLIT PËR MAKINAT NË PËRDORIM

Koha totale e përdorimit, riparimet dhe garancitë

61. Për të nxitur sisteme të qëndrueshme të kontrollit të shkarkimeve, duhet të merren parasysh ato standarde të cilat nuk duhen kaluar gjatë “kohës totale të përdorimit të automjetit”. Për ta përmbushur këtë kërkesë, nevojiten programe monitorimi. Në bazë të këtyre programeve, prodhuesit kanë përgjegjësi për riparimin e mjeteve të cilat nuk i përmbushin standardet e kërkuara. Për të siguruar që pronari i mjetit të mos ketë probleme të lidhura me prodhimin, prodhuesit e tyre duhet të japin garanci për komponentët e kontrollit të shkarkimeve.

62. Nuk duhet të ketë asnjë pajisje që të ulë efikasitetin ose të bllokojë sistemet e kontrollit të shkarkimeve gjatë punës së mjetit, me përjashtim të kushteve që janë të domosdoshme për funksionimin sa më të mirë të motorit (për shembull ndezja në mot të ftohtë).

Inspektimi dhe mirëmbajtja

63. Programi i inspektimit dhe mirëmbajtjes ka një funksion të dytë të rëndësishëm. Ai mund të nxisë mirëmbajtjen e rregullt të automjeteve dhe të bëjë që pronarët e automjeteve të heqin dorë nga manipulimi apo nxjerrja jashtë funksionit e pajisjeve për kontrollin e shkarkimeve, si nëpërmjet zbatimit të detyrueshëm të rregulloreve, ashtu edhe me anë të informimit të publikut. Inspektimi duhet të verifikojë që kontrollet e shkarkimeve po kryhen sipas renditjes së funksionimit të tyre normal.

64. Monitorimi në rritje i performancës së kontrollit të shkarkimeve mund të arrihet me anë të sistemeve diagnostifikuese të instaluar në mjetin motorik, të cilat monitorojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të shkarkimit, ruajnë kodet e gabuara për vrojtim të mëtejshëm, si edhe tërheqin vëmendjen e shoferit për të bërë riparimin e mjetit në rast mosfunksionimi.

65. Programet e inspektimit dhe mirëmbajtjes mund të jenë të dobishme për të gjitha llojet e teknologjive të kontrollit duke siguruar që nivelet e shkarkimit të mjeteve të reja janë ruajtur. Për automjetet me kontroll katalitik është e rëndësishme të sigurohet se karakteristikat e mjeteve të reja janë ruajtur për të shmangur përkeqësimin e tërë ndotësve kryesorë, duke përfshirë edhe oksidet e azotit.

TABLE 1

[illegible]

Energy source	Uncontrolled Emissions		Process and Combustion Modifications				Flue Gas Treatment				
	mg/m ³ ^{1/}	g/GJ ^{1/}	mg/m ³ ^{1/}	g/GJ ^{1/}	ECU/kW _d ^{2/}	mg/m ³ ^{1/}	g/GJ ^{1/}	ECU/kW _d ^{2/}	mg/m ³ ^{1/}	g/GJ ^{1/}	ECU/kW _d ^{2/}
Coal, PF ^{2/}	600-2 200	200-770	up to 700	up to 245							
Coal, grates ^{2/}	150-600	50-200	up to 500	up to 175							
Brown coal	200-800	80-340									
Heavy oil ^{2/}	400-1 000	110-280	up to 650	up to 180							
Light oil ^{2/}	150-400	40-110	up to 250	up to 70							
Natural gas ^{2/}	100-300	30-80	up to 150	up to 42	2-10						
Gas turbines + CCGT: ^{1/} , ^{2/}											
natural gas	165-310	140-270	30-150	26-130	Dry: 50-100 ECU/kW _d	NA	20	17			
diesel oil	235-430	200-370	50-200	45-175	Wet: 10-50 ECU/kW _d	NA	120-180	70			
FBC ^{2/}	100-700		100-600								
IC Engines (natural gas < 1 MWel) ^{2/}	4800-6300	1500-2000	320-640	100-200							
Industrial processes:											
Calcination	1000-2000		500-800								
Glass:											
Plate glass		6 kg/t	500-2000				<500				
Containers		2.5 kg/t									
Fibreglass		0.5 kg/t									
Industrial		4.2 kg/t									
Metals:											
Sintering	300-500 ^{1/}	1.5 kg/t					<500				
Coke ovens	1 000	1 kg/t									
Baked carbon fuels	< 3 000										
Electric arc furnaces	50-200										
Paper and pulp:											
Black liquor	170 ^{1/}	(50-80 g/GJ)		(20-40 g/GJ)		60					13-20

Energy source	Uncontrolled Emissions mg/m ³ ^{1/} kg/t ^{2/}	Process and Combustion Modifications mg/m ³ ^{1/} kg/t ^{2/} ECU/t ^{2/}	Flue Gas Treatment			
			(a) Non-catalytic		(b) Catalytic (after primary measures)	
			mg/m ³ ^{1/} kg/t	ECU/kWel ^{2/}	mg/m ³ ^{1/} kg/t ^{2/}	ECU/kWel ^{2/}
<i>Source category (iv): Non-combustion processes</i>						
Nitric acid:						
Low pressure (1-2.2 bar)	5 000	16.5				
Medium pressure (2.3-8 bar)	approx. 1 000	3.3				
High pressure (8-15 bar)	< 380	< 1.25				
HOKO (-50 bar)	< 380	< 1.25			0.01-0.8	
Pickling:						
Brass	25 ^{10/}					
Stainless steel	0.3					
Carbon steel	0.1					

Energy source	Uncontrolled Emissions mg/m ³ ^{1/} g/GJ ^{1/}	Process and Combustion Modifications mg/m ³ ^{1/} g/GJ ^{1/} ECU/kWel ^{2/}	Flue Gas Treatment			
			(a) Non-catalytic		(b) Catalytic (after primary measures)	
			mg/m ³ ^{1/} g/GJ ^{1/}	ECU/kWel ^{2/}	mg/m ³ ^{1/} g/GJ ^{1/}	ECU/kWel ^{2/}
<i>Source category (v): Extraction, processing and distribution of fossil fuels</i>						
Refineries ^{5/}	~1 000	100-700				
<i>Source category (vi): Waste treatment and disposal</i>						
Incineration ^{11/}	250-500	200-400			< 100	

¹ Emissions in mg/m³ NO₂ (STP dry) resp. g/GJ thermal input. Conversion factors (mg/m³ to g/GJ) for NO_x emissions from coal (hard coal): 0.35, coal (lignite): 0.42, oil/gas: 0.277, peat: 0.5, wood + bark: 0.588 [1 g/GJ = 3.6 mg/kWh]. ² Total investments

³ ECU = 2 DM. ⁴ Reduction generally achieved in combination with primary measures. Reduction efficiency between 80 and 95 per cent. ⁵ At 6 per cent O₂.

⁶ At 3 per cent O₂.

⁷ Incl. costs for boiler.

⁸ At 7 per cent O₂.

⁹ Emissions from industrial processes are generally expressed as kg/t of product.

¹⁰ g/m³ surface area.

¹¹ At 11 per cent O₂. ¹² Tail gas SCR configuration as opposed to high dust.

¹³ At 15 per cent O₂.

¹⁴ Bitumen emulsion.

¹⁵ Untreated wood only.

¹⁶ Heat recovery and gas recirculation. ^{17/} For dry substance <75%.

^{18/} With supplementary firing, approximate additional thermal NO_x: 0-20 g/GJ.

NA: not applicable

No data: technology applied, but no data available

TABLE 2

Emission control technologies for petrol- and diesel-fuelled passenger cars and light commercial vehicles

	Technology option	NOx emission level (per cent)	Estimated additional production cost ¹ (US\$)
Petrol-fuelled			
A.	Uncontrolled situation	100	-
B.	Engine modifications (engine design, carburation and ignition systems, air injection)	70	2
C.	Open-loop catalyst	50	150-200
D.	Closed-loop three-way catalyst	25	250-450 ²
E.	Advanced closed-loop three-way catalyst	10	350-600 ³
F.	Californian low-emission vehicles (advanced option E)	16	> 700 ³
Diesel-fuelled			
G.	Conventional indirect injection diesel engine	40	
H.	Indirect injection engine with secondary injection, high injection pressures electronically controlled	30	1 000-1 200 ⁴
I.	Direct injection engine with turbocharging	50	1 000-1 200 ⁴

NOTE: Options C, D, E, F require the use of unleaded petrol; options H and I require the use of low-sulphur diesel fuel.

¹ Per vehicle, relative to technology option B. NOx requirements may have an effect on fuel prices and refinery production costs, but this is not included in the estimated additional production cost.

² Costs for engine modifications from options A to B are estimated at US\$ 40-100.

³ Under technology options D, E and F, CO and VOC emissions are also substantially reduced, in addition to NOx reductions. Technology options B and C result also in CO and VOC control.

⁴ Fuel consumption is reduced as compared to option G, while particulate emissions of technology option G are considerably higher.

TABLE 3

Heavy-duty vehicle technologies, emission performance and costs

	Technology option	NO _x emission level (%)	Expected additional production cost ¹ £ (US\$)
A.	Turbocharged diesel engine (EURO I)	100	0
B.	Turbocharged diesel engine with intercooling (EURO II)	85	1 500-3 000
C.	Turbocharged diesel engine with intercooling, high pressure fuel injection, electronically controlled fuel pump, combustion chamber and port optimization, exhaust gas recirculation (EGR)	50-60	3 000-6 000
D.	Shift to spark ignition engine with three-way-catalytic converter working on LPG, CNG or oxygenated fuels	10-30	up to 10 000

Note: Option C requires the use of low-sulphur diesel fuel.

¹/ Per vehicle, and depending on engine size relative to baseline technology A. NO_x requirements may have an effect on fuel prices and refinery production costs, but this is not included in the estimated additional production cost.

LIGJ
Nr.10 063, datë 29.1.2009

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN “PËR
REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE TË SQUFURIT APO TË FLUKSEVE TË TYRE
NDËRKUFITARE, TË PAKTËN NË MASËN 30 PËR QIND” TË KONVENTËS SË VITIT
1979 “PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të sqfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind” të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6045, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI I KONVENTËS I VITIT 1979
PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT MBI REDUKTIMIN E
SHKARKIMEVE TË SQUFURIT OSE TË FLUKSEVE TË TYRE NDËRKUFITARE TË PAKTËN
NË MASËN 30%

Palët,

të vendosura për të zbatuar Konventën për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët;

të shqetësuara nga fakti që shkarkimet aktuale të ndotësve të ajrit, po shkaktojnë dëmtime të mëdha në pjesët e ekspozuara të Europës dhe Amerikës së Veriut, ndaj burimeve natyrore me rëndësi jetike për mjedisin dhe ekonominë, të tilla si pyjet, toka dhe ujërat, si edhe ndaj materialeve të ndryshme (duke përfshirë monumentet historike) dhe që në rrethana të caktuara kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njeriut;

të vetëdijshme për faktin se burimet mbizotëruese të ndotjes së ajrit, të cilat kontribuojnë në acidifikimin e mjedisit, janë djegia e lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë, proceset kryesore teknologjike në sektorë të ndryshëm të industrisë, si edhe transporti, të cilat çojnë në shkarkimin e dyoksidit të sqfurit, oksideve të azotit dhe ndotësve të tjerë;

duke pasur parasysh që duhet t'i jepet një përparësi e madhe reduktimit të shkarkimeve të sqfurit, çka do të ketë rezultate pozitive nga pikëpamja mjedisore, për situatën ekonomike në tërësi dhe shëndetin e njeriut;

duke kujtuar vendimin e marrë nga Komisioni Ekonomik për Europën (KEE) i Kombeve të Bashkuara në sesionin e tij të 39-të, i cili theksoi nevojën urgjente të shtimit të përpjekjeve për të arritur në strategji dhe politika kombëtare të bashkërenduara në rajonin e KEE-së me qëllim që të reduktohen në mënyrë të efektshme shkarkimet e sqfurit në nivelet kombëtare;

duke kujtuar njohjen nga organi ekzekutiv i Konventës në sesionin e tij parë të nevojës për të pakësuar efektivisht shkarkimet totale vjetore të përbërjeve të sqfurit ose të flukseve të tyre

ndërkufitare gjatë periudhës 1993-1995, duke përdorur nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjet e reduktimeve;

duke kujtuar se Konferenca shumëpalëshe për shkaqet dhe parandalimin e dëmtimeve të pyjeve dhe ujërave nga ndotja e ajrit në Europë (Munih 24-27 qershor 1984) kërkoi që organi ekzekutiv i Konventës të miratojë, si një çështje me përparësi të madhe, propozimin për një marrëveshje të veçantë mbi reduktimin e shkarkimeve kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare jo më vonë se viti 1993;

duke vërejtur se një pjesë e palëve kontraktuese të Konventës kanë vendosur të zbatojnë reduktimet e shkarkimeve të tyre kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën deri në masën 30 % sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, duke marrë nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjet e reduktimeve;

duke pranuar, nga ana tjetër, se disa prej palëve kontraktuese të Konventës, pavarësisht se nuk e kanë firmosur këtë protokoll në momentin e hapjes së tij për nënshkrim, megjithatë do të japin një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e ndotjes ndërkufitare të ajrit, ose do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të kontrolluar shkarkimet e squfurit, siç deklarohet në dokumentin që i bashkëngjitet raportit të organit ekzekutiv në sesionin e tij të 3-të,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokollit:

1. “Konventa” është Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, e miratuar në Gjenevë më 13 nëntor 1979.

2. “EMEP” është programi i bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Europë;

3. “Organi ekzekutiv” është organi ekzekutiv i Konventës i krijuar sipas paragrafit të parë të nenit 10 të Konventës.

4. “Zona gjeografike e veprimit të EMEP” është zona e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 1 të Protokollit të Konventës së vitit 1979 për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët në lidhje me financimin afatgjatë të programit të bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Evropë (EMEP), i miratuar në Gjenevë më 28 shtator 1984.

5. “Palët” janë, përveç rastit kur konteksti e kërkon ndryshe, palët në këtë protokoll.

Neni 2

Dispozitat themelore

Palët duhet të reduktojnë shkarkimet e tyre kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën në masën 30%, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, duke marrë nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjet e këtyre reduktimeve.

Neni 3

Reduktimet e mëtejshme

Palët njohin nevojën e secilës prej tyre për të studiuar në shkallë kombëtare domosdoshmërinë për reduktime të mëtejshme, përtej niveleve që iu referohet neni 2, të shkarkimeve të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare, në rast se kushtet e mjedisit e kërkojnë një gjë të tillë.

Neni 4

Raportimet mbi shkarkimet vjetore

Çdo palë duhet të informojë çdo vit organin ekzekutiv në lidhje me nivelin e shkarkimeve të tyre vjetore të squfurit dhe bazën mbi të cilën ato janë llogaritur.

Neni 5

Përlllogaritjet e flukseve ndërkufitare

EMEP-i duhet që, në kohën e duhur, para mbledhjeve vjetore të organit ekzekutiv, t'i sigurojë organit ekzekutiv përlllogaritjet e sasive të squfurit, si edhe të flukseve ndërkufitare dhe depozitimeve të përbërjeve të squfurit për secilin vit të mëparshëm brenda zonës gjeografike të veprimit EMEP-it, duke përdorur modelet e përshtatshme. Në rajonet jashtë zonës gjeografike të veprimit të EMEP-it, duhet të përdoren modele të përshtatshme me rrethanat e veçanta të palëve.

Neni 6

Programet, politikat dhe strategjitë kombëtare

Palët duhet që, në kuadrin e Konventës, të hartojnë pa vonesë, programet, politikat dhe strategjitë kombëtare, të cilat do të shërbejnë si një mënyrë për të reduktuar shkarkimet e squfurit ose flukset e tyre ndërkufitare, të paktën deri në masën 30% sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, dhe duhet të raportojnë në lidhje me këtë në organin ekzekutiv, si dhe për ecurinë në drejtim të arritjes së këtij synimi.

Neni 7

Amendamentet e protokollit

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente të këtij protokollit.
2. Propozimet e amendamenteve duhet të paraqiten me shkrim në sekretariatin ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili ua komunikon ato të gjitha palëve. Organi ekzekutiv duhet të diskutojë amendamentet e propozuara në mbledhjen e tij vjetore më të afërt, me kusht që propozimet të jenë qarkulluar tek palët nga sekretariati ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën të paktën 90 ditë më parë.
3. Një amendament i këtij protokollit duhet të miratohet me konsensusin e përfaqësuesve të palëve, dhe do të hyjë në fuqi për palët që e kanë pranuar atë në ditën e 90-të pas datës në të cilën dy të tretat e palëve kanë depozituar instrumentet e tyre të pranimin të këtij amendamenti. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e 90-të, duke filluar nga data në të cilën kjo palë depoziton instrumentet e saj të pranimin të këtij amendamenti.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lind një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë palëve përsa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij protokollit, ato duhet të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve apo nëpërmjet çdo mënyre tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pranueshme për palët në konflikt.

Neni 9

Nënshkrimi

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Helsinki (Finlandë) nga data 8 korrik 1985 deri në dhe duke e përfshirë datën 12 korrik 1985, nga vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, si dhe nga vendet e pranuar me statusin konsultativ pranë Komisionit Ekonomik për Europën, në pajtim me paragrafin 8 të Rezolutës 36 (IV) datë 28 mars 1947 të Këshillit Ekonomik dhe Social, si edhe nga organizatat e integritit ekonomik rajonal, të krijuara nga shtetet sovranë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilat kanë kompetenca në drejtim të zhvillimit të negociatave, lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me çështjet që trajtohen nga ky protokoll, me kusht që shtetet dhe organizatat e interesuara të jenë palë në Konventë.

2. Përsa u përket çështjeve që janë brenda kompetencave të tyre, këto organizata të integritit ekonomik rajonal duhet që, në emër të tyre, të ushtrojnë të drejtat dhe të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë që cakton ky protokoll për vendet e tyre anëtare. Në raste të tilla, vendet anëtare të këtyre organizatave nuk mund t'i ushtrojnë këto të drejta individualisht.

Neni 10
Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll duhet të ratifikohet, pranohet apo miratohet nga vendet nënshkruese.
2. Ky protokoll do të jetë i hapur për aderim nga ana e shteteve dhe organizatave të referuara në paragrafin 1 të nenit 9, duke filluar nga data 13 korrik 1985.
3. Një shtet ose një organizatë që aderon në këtë protokoll pas hyrjes së tij në fuqi, duhet të zbatojë nenin 2 jo më vonë se viti 1993. Megjithatë, në qoftë se aderimi në protokoll ka ndodhur pas vitit 1990, neni 2 mund të zbatohet nga pala në fjalë pas vitit 1993, por jo më vonë se viti 1995 dhe për pasojë kjo palë duhet të zbatojë nenin 6.
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose të aderimit do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e personit të besuar.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.
2. Për çdo shtet ose organizatë të përmendur në paragrafin 1 të nenit 9, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll, ose aderon në të pas depozitimit të aktit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimi, miratimit apo aderimit, protokollin do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga kjo palë e aktit të saj të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.

Neni 12
Tërheqja

Në çdo moment pas pesë vjetësh, duke filluar nga data në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi për një palë të caktuar, kjo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll duke bërë njoftim me shkrim në drejtim të personit të besuar. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit nga personi i besuar.

Neni 13
Tekstet origjinale

Origjinali i këtij protokoll, tekstet e të cilit në anglisht, frëngjisht dhe rusisht, janë njëloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar ligjërisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.
- Bërë në Helsinki më 8 korrik 1985.

LIGJ
Nr.10 064, datë 29.1.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE BANKËS SË GREQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës së Greqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6046, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE
BANKËS SË GREQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, dhe Banka e Greqisë kanë rënë dakord për shlyerjen e borxhit që rrjedh nga Marrëveshja ndërmjet Bankës së Greqisë dhe Bankës së Shtetit të Shqipërisë të datës 19.11.1987 (Gjendja e llogarisë së veçantë 88-89) dhe kanë pranuar sa më poshtë:

Neni 1

Borxhi total i Palës Shqiptare kundrejt Bankës së Greqisë më 30 prill 2008 arrin më 7574 550.97 USD për t’u paguar brenda pesë (5) vjetëve si më poshtë:

Neni 2

Borxhi duhet të paguhet një të dhjetë (1/10) këste pagesash të principalit dhe interesit. Kësti i parë llogaritet të jetë i kërkueshëm më 31 tetor 2008 dhe paguhet jo më vonë se 31 janar 2009, pa kamatëvonesa. Kësti i fundit është i kërkueshëm dhe i pagueshëm më 30 prill 2013. Këstet e tjera për vitet 2009 dhe 2012 bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme më 30 prill dhe 31 tetor të çdo viti. Shtojca 1 e kësaj Marrëveshjeje jep hollësitë për pagesat përkatëse dhe llogaritë.

Neni 3

Çdo këst përbën një të dhjetën (1/10) e borxhit, 757 455.10 USD, plus interesin gjysmëvjeçar, që llogaritet mbi borxhin që mbetet pas secilës pagesë duke përdorur normën Libor (USD) gjashtëmujor që zbatohet në ditën e parë të punës të çdo gjysmë viti. Interesi llogaritet duke filluar nga 1 maj 2008. Banka e Greqisë njofton me shkrim Ministrinë e Financave të Shqipërisë në lidhje me shumën e saktë të secilit këst jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkueshme.

Neni 4

Nëse një pagesë nuk bëhet në kohën e duhur, zbatohet me kamatëvonesë. Kamatëvonesa llogaritet me normën prej një për qind (1%) mbi normën e interesit të parashikuar në nenin 3. Shuma e kamatëvonesës llogaritet mbi shumën e pagesës së vonuar për periudhën nga data e kërkueshme deri në datën në të cilën bëhet pagesa.

Neni 5

Korrespondenca në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është në gjuhën angleze dhe drejtohet në adresat si më poshtë:

a) Banka e Greqisë, Departamenti i Operacioneve Financiare dhe Llogarive Qeveritare. Seksioni i Dokumentacionit të Kredive

Adresa: Panepiotimion 21
10250 Athens,
Greece
Tel.No: +30 210 3202991/3203003
Faks No: +30 210 3233872
b) Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1
Tiranë, Albania
Tel.No: +355 4222 8405
Faks No: +355 4222 8494

Neni 6

Palët bien dakord të zgjidhin, nëpërmjet konsultimeve, çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga kjo Marrëveshje. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet, ajo zgjidhet ekskluzivisht në gjykatat e Londrës dhe zbatohet ligji anglez.

Neni 7

Kjo Marrëveshje ndryshohet në mënyrë të efektshme vetëm me shkrim.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha janë njëlloj autentike. Secila palë ka marrë një komplet kopjesh origjinale. Në rastin e mospërputhjes ndërmjet versioneve të ndryshme të gjuhëve të kësaj Marrëveshjeje, mbizotëron versioni në anglisht.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCave
Ridvan Bode
Tiranë më 18.12.2008

PËR BANKËN E GREQISË
GUVERNATORI
George A.Provopoulos
Athens on 23.12.2008

SHTOJCA 1

HOLLËSI PËR PAGESËN DHE LLOGARINË

Ministria e Financave të Shqipërisë do të bëjë pagesa gjysmëvjetore në llogarinë e Bankës së Greqisë në Bankën e Rezervave Federale të Nju-Jorkut. Hollësitë e pagesës janë si më poshtë:

Banka jonë korrespondente:
Banka e Rezervave Federale të Nju-Jorkut, Nju-Jork
Kodi SWIFT: FRNYUS33
Nr.i llogarisë sonë: 021084050
Banka përfituese: Banka e Greqisë, Athinë
Kodi SWIFT: BNGRGRAA

Me marrjen e secilës pagesë në regjistrat e Bankës së Greqisë do të bëhet një hyrje përkatëse nën “Llogarinë e veçantë 88-89”.

Po ashtu, Banka e Greqisë do të njoftojë Ministrinë e Financave të Shqipërisë për lëvizjen e llogarisë së sipërpërmendur, si dhe balancën e mbetur, së cilës i është zbritur pagesa e kryer.

LIGJ
Nr.10 065, datë 29.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2 e shtojcës nr.3 “Taksa e akteve dhe pullës”, e përmendur në pikën 5 të nenit 4, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4 “Niveli i taksave” pika 2, fjalia e fundit shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 11 “Tarifat e shërbimit” bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6047, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr.82, datë 27.1.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË

MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHËTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shëtitit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shëtitit”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 1 e vendimit nr.883, datë 22.12.2004 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e një pjese të punonjësve të Drejtorisë së Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve e të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

[illegible]

VENDIM
Nr.98, datë 27.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE
TË NDËRMARRJEVE APO TË OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË VEÇUARA, TË
PRIVATIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim, shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", dhe të nenit 4, të ligjit nr.7980, datë 27.9.1995 "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË PRIVATIZUARA

1. Shitja e truallit të pasitur të ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore, të privatizuara, nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, degët e saj në rrethe, nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të NB-ve, me degët e saj në rrethe, dhe nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), të bëhet në përputhje me këtë vendim, sipas genplanit, që i bashkëlidhet dosjes së privatizimit.

2. Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) kryen edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive.

3. Të gjitha subjektet, të cilat kanë privatizuar objekte apo ndërmarrje, sipas pikave 1 e 2 të këtij kreu, por që nuk kanë privatizuar sipërfaqen e truallit, sipas genplanit të dokumentacionit të privatizimit, duhet ta blejnë këtë truall deri më 31.5.2009, si dhe të kenë paguar qiranë e truallit rregullisht, deri në pagesën e vlerës së plotë të çmimit të truallit, brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë.

4. Pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu, në rastet kur nuk është paguar qiraja dhe nuk është blerë trualli nga pronarët e objekteve apo të ndërmarrjeve të privatizuara, trualli i tyre vihet në dispozicion të AKKP-së për kompensimin e subjekteve të shpronësuara dhe, në rastet, kur trualli ka pronarë, të njohur me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, trualli i kalon këtij pronari.

5. Personi fizik apo juridik, privat, i cili do ta blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve, që ka privatizuar më parë, sipas përcaktimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, duhet të paraqesë në dy kopje, në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesën me shkrim për blerje të truallit;
- Vërtetimin hipotekor, certifikatën e pronësisë, të noterizuar, nëse ka, kartelën e pasurisë etj., për objektin, të lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe hartën treguese të pasurive të paluajtshme, në zonën përkatëse, nëse është e përditësuar jo më pak se 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës;
- Fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitjes së objektit apo ndërmarrjes, lëshuar nga ish-AKP-ja, ish-AQRNB-ja, Ministria e Financave (DASHPP-ja) dhe nga ndërmarrjet përkatëse, përpara krijimit të agjencive, fotokopje të noterizuar të genplanit apo planimetrisë së objektit (në çastin e privatizimit);
- Deklaratën noteriale origjinale, në dy kopje, që vërteton se nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës së mësipërme, për rastet kur privatizimet janë kryer nga ish-AKP-ja dhe degët e saj në rrethe, nëse dosja e privatizimit gjendet e rregullt, dhe brenda 7 ditëve nga mbërritja e dokumentacionit të privatizimit, nga drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes

së konsumatorit (DRBUMK), për privatizimet e kryera nga ish-AQRNB-të, i kërkon zyrës rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në qarkun përkatës, dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që të konfirmojnë statusin e truallit, çmimin përkatës të shitjes, të përcaktuar në hartën e çmimeve, në zbatim të vendimit nr.183, datë 23.4.2005 të Kuvendit, dhe hartën treguese, me të dhënat e nevojshme gjeografike për zonën përkatëse, nëse ato janë të përditësuara.

7. Zyra rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kthejnë përgjigje Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

8. Në rastet kur konfirmohet se trualli i objekteve apo ndërmarrjeve të shitura ka pronarë, të njohur me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, apo ka pronar shtetin, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryen shitjen e truallit dhe lidhjen e kontratës.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës apo paraqitja e dosjes së privatizimit nga DRBUMK-ja, u kërkon organeve përkatëse të qeverisjeve vendore apo çdo organi tjetër shtetëror, me të cilin subjektet kanë lidhur kontratë qiraje për truallin, vërtetimin për pagesën e qirasë së truallit, për objektin apo ndërmarrjen, nga subjekti kërkues deri në çastin e pagesës së vlerës së plotë të çmimit të truallit, sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, koeficientin e llogaritjes së bashkëpronësisë së truallit (organi i qeverisjes vendore), për rastet kur objekti është me dy apo më shumë kate, si dhe dërgon dokumentacionin sipas pikës 5 të këtij vendimi.

10. Vlera e qirasë së tokës, e arkëtuar pranë organeve të qeverisjes vendore apo organeve të tjera shtetërore, me të cilat subjektet kanë lidhur kontratë qiraje, ndahet si më poshtë:

- 5 %, Ministria e Financave;
- 65%, Buxheti i Shtetit;
- 30%, organi i qeverisjes vendore apo organi shtetëror përkatës.

11. Të ardhurat e arkëtuara nga shitja e truallit do të kalojnë 100 % për Buxhetin e Shtetit, për efekt të fondit të kompensimit financiar, për subjektet e shpronësuara.

12. Organet e qeverisjes vendore apo organi tjetër shtetëror, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie vërtetimin, nëse subjekti kërkues ka paguar qiranë e truallit dhe koeficientin e bashkëpronësisë për objektet me dy apo më shumë kate.

Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie hartën treguese përkatëse, me të dhënat e nevojshme gjeografike dhe statusin e truallit.

13. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, zyrat rajonale të kthimit të kompensimit të pronave apo organet e tjera shtetërore, njofton kërkuesin për t'u paraqitur pranë këtij institucioni, për të marrë autorizimin për pagesën e vlerës së truallit. Pagesa kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit. Pas kryerjes së pagesës së vlerës së plotë të truallit, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave, në Ministrinë e Financave, lidh kontratën e shitjes së truallit me blerësin.

14. Pagesa e çmimit të truallit të objektit apo ndërmarrjes, që është privatizuar ose do të privatizohet, bëhet vetëm në lekë.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Pagesa e qirasë së truallit për subjektet, që e kanë paguar dhe e paguajnë rregullisht atë, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara, bëhet në zbatim të akteve ligjore a nënligjore, sipas periudhave përkatëse dhe kontratave të qirasë, të lidhura për këtë qëllim.

2. Ky vendim nuk do të zbatohet për procedurat e vlerësimit të truallit të objekteve apo ndërmarrjeve, dokumentacioni i të cilave është në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe ndodhen në fazën kur:

- a) ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të tyre;
- b) kanë filluar procedurat e publikimit, sipas vendimeve të mëparshme, deri në datën e hyrjes

në fuqi të këtij vendimi;

c) është konfirmuar nga organet e qeverisjes vendore vlera përkatëse e truallit, sipas legjislacionit të periudhës përkatëse, dhe nga AKKP-ja.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi nr.850, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.2.2009
Doli nga shtypi më 9.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë